REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. No. 01-060/01-0021492/20
Data Data 22.06.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës /Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Ne mbështetje të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, si dhe Rregullores së Punë se Kuvendit, përkatësisht neni 5, si dhe ne pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve.

F T O H E N I

Që të merrni pjesë në **Mbledhjen e Kuvendit Komunal-Skenderaj** e cila do të mbahet me datën; **30.06.2020,** me fillim prej orën **11:00**, në Sallën e Kuvendit Komunal.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

R E N D D I T E

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhjet e kaluara;
4. Propozim-Vendimin për përkrahjen e bizneseve, fermerëve dhe OJQ-ve në rimëkëmbjen e tyre pas gjendjes emergjente të shkaktuar nga pandemia COVID-19, më nr. 02-313/01-0018872/20, të dt.12.06.2020, (Raporton Kryetari i Komunës z. Bekim Jashari);
5. Korniza Afatmesme e Buxhetit 2021-2023, me nr.02-400/01-0018819/20, e dt.11.06.2020, (Raporton Drejtori për Buxhet dhe Financa z. Kastriot Gashi);
6. Propozim-Vendim për Miratimi e Grandeve të DBPZHR-së, për vitin 2020, më nr.10-320/01-0017917/20, të dt.08.06.2020, (Raporton Drejtori i DBPZHR-së z. Sokol Sallahu);
7. Informatë rreth aktiviteteve të Drejtorisë për Inspekcion për periudhën Janar-Qershor 2020, me nr.13-334/01-0021384/20, i dt.22.06.2020, (Raporton Drejtori për Inspekcion z. Arton Veliu);
8. Rekomandim i Komitetit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, me nr.01-060/01-0020746/20, 19.06.2020, (Raporton Kryesuesja e Komitetit znj. Fatmire Bajraktari);
9. Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme.

REPUBLIKA E KOSOVËS • KOMUNA E SKENDERAJT • KUVENDI I KOMUNËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO • SKENDERAJ • SKUPŠTINA OPŠTINA • MUNICIPALITY OF

Kryesuesja e KK-së
znj. Fatbardha Haliti

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠINA
SKENDERAJ
Nr. No. 01-060/01-0021492/20
Data Data 22.06.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republicof Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës /SkupštinaOpštine/MunicipalityofAssembly

EKSTRAKT NGA PROCESVERBALI I MBËLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL I MBAJTUR MË DATËN: 29.05.2020,

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 37 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr. 01-110-385 të dt.03.12.2008, Rregulloren e punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

F T O H E N I

Kryesuesja e Kuvendit pasi konstatoj së ekziston kuorumi për mbajtjen e kësaj mbledhje të Kuvendit Komunal Skenderajt, propozon:

R E N D D I T E

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhjet e kaluara,
4. Raporti Financiar i Realizimit të Buxhetit Komunal Janar-Mars 2020, me nr.02-052/01-00145565/20, i dt.12.05.2020,(Raporton Drejtori për Buxhet dhe Financa z. Kastriot Gashi),
5. Raport i Zyrës së Prokurimit për muajit Janar-Prill 2020, me nr.03-052/01-0014227/20, i dt.05.05.2020, (Raporton Drejtori për Buxhet dhe Financa z. Kastriot Gashi),
6. Informatë për periudhën Janar-Prill 2020, lidhur me mirëqenien sociale, strehimi familjar, përkujdesja për të moshuarit, me nr. 08-052/01-0015493/20, e dt.21.05.2020, (Raporton Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z. Ibush Hetemi),
7. Rekomandim i Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim, me nr. 01-060/01-0014981/20, i dt.18.05.2020, (Raporton Kryesuesi i Komitetit z. Berat Dajaku),
8. Plani i Punës i Komitetit Këshillues për Arsim, Kulturë, Fe, Rini e Sport për vitin 2020, më nr.01-112/01-0000741/20, i dt.06.01.2020, (Raporton Kryesuesi i Komitetit z. Fadil Shaqiri),
9. Plani i Punës i Komitetit Konsultativ për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore për vitin 2020, më nr.01-112/01-0013415/20, i dt.20.03.2020, (Raporton Kryesuesja e Komitetit znj. Fatmire Bajraktari),
10. Plani i Punës i Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2020, me nr. 01-112/01-0013248/20, i dt. 13.03.2020, (Raporton Kryesuesja e Komitetit znj. Emine Goxhuli),
11. Plani i Punës i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike për vitin 2020, me nr. 01-112/01-0000967/20, i dt. 08.01.2020,(Raporton Kryesuesja e Komitetit znj. Vlora Gashi),
12. Propozim-vendim për shpalljen e zonës me interes publik ngastrën ne zonat katastralë Skenderaj dhe Klinë e Poshtme dhe bartjen e tyre ne pronësi të Komunës së Skenderajt, me nr.05-463/01-0016078/20, i dt.28.05.2020, (Raporton Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronësi z. Ramiz Shala), (Pike shtesë)
13. Pyetjet e këshilltarëve nën pika të ndryshme.

Kryesuesja: Të nderuar të pranishme i nderuar Kryetar i Komunës së Skenderajt z. Bekim Jashari, i nderuar Nënkryetar i Komunës z. Nuredin Lushtaku, të nderuar anëtar të KK-së të Skenderajt, Drejtor të Drejtorive, përfaqësueses të OSBE-së, shoqëri civilë KFOR, Media dhe gjithë të pranishëm, shkojmë në konstatime e kuorumit në sallë janë 25 Anëtare, mungon Lavdije Geci qe gjendet jashtë vendi e nuk mundet me udhëtua për shkak të virusit Covid-19 qe po ndodh, ndërsa Naser Bajraktari, Ilir Ejupi, Albert Rexhepi dhe Donika Rushiti bashkëngjiten gjatë mbledhjes, Para miratimit të rendit të ditës e kemi një pikë shtesë:

Propozim-vendim për shpalljen e zonës me interes publik ngastrën ne zonat katastralë Skenderaj dhe Klinë e Poshtme dhe bartjen e tyre ne pronësi të Komunës së Skenderajt, me nr.05-463/01-0016078/20, i dt.28.05.2020(Raporton Kryetari i Komunës z. Bekim Jashari);

-**Kryetari i Komunës z. Bekim Jashari;** Përshëndetje për të gjithë si pikë shtesë e keni Propozim-vendim për shpalljen e zonës me interes publik ngastrën ne zonat katastralë Skenderaj dhe Klinë e Poshtme dhe bartjen e tyre ne pronësi të Komunës së Skenderajt, vetëm këto prona na kanë mbet pa ju kthye komunës ju lus me përkrah te shtohet si pike shtesë dhe me vonë të miratohet.

Kryesuesja: Faleminderit kryetar, e hapë debatin për këtë pikë, fjalën ja kaloj Azem Gashi dhe Pajazit Isufi;

Azem Gashi: Përshëndetje për të gjithë, a banë me na dhënë ma shume sqarime për këto ngastra se ku gjenden?

Pajazit Isufi: Përshëndetje për të gjithë, pyetje; Ngastrat 111-0 dhe ngastra 112-0 a janë ngastra të vjetra qe i kemi votua para 3 seancave, qe mos ti votojmë ka 2 herë për të njëjtat ngastra?

Kryesuesja: Faleminderit, fjalën ja kaloj Musaj Hajdari:

Musaj Hajdari: Përshëndetje për të gjithë, mendoj qe diskutimet e pyetjet qe po behën për piken shtesë, nuk ka nevojë me u bë tash duhet me u be ne fund të miratimit te kësaj pike.

Kryesuesja: Faleminderit fjalën ja kaloj kryetarit të komunës;

Kryetari i Komunës z. Bekim Jashari: Këto sqarime do ti jepe drejtori i DGJKP-së z. Ramiz Shala, ja në fund te seancës kur ti vjen radha për miratim te kësaj pike qysh e tha Musa Hajdari. Ngastrat qe i ceke Pajazit Isufi nuk janë të njëjta janë zona qe kanë mbet jashtë përfshirjes, drejtori z. Ramiz Shala erdhi dhe e ftoj me dhënë sqarime.

Ramiz Shala: Përshëndetje për të gjithë, këto ngastra qe janë si pikë shtesë janë ngastra nen pronësinë Përparimi qe janë nen menaxhimin e AKP-së. Ngastra nr. 733-2 , 734-1, 734-2, 735-2 ndodhet përball trafos të silluesi ne Klinë të Poshtme kurse ngastra nr.111-0, 112-0 ndodhen ne shesh, këto prona po i marrim nga AKP-ja dhe po ja kthejmë Komunës së Skenderajt, çka ka të pa qartë këtu jam këtu për sqarime materialin e keni përpara, ju lusë më përkrah së po ju shtohet pasuria e komunës së Skenderajt.

Kryesuesja: Faleminderit, dikush tjetër, fjalën ja kaloj Ismet Salihu dhe Isa Fejzullahi:

Ismet Saihu: Përshëndetje për të gjithë, përshëndetje për Drejtorin e ri z. Abdyl Imeri, urime detyra e Drejtorit të DKRS-së suksese në pune. Jam me e votua çdo prone që është nen menaxhimin e AKP-së me ja kthye komunës, po për do prona është mirë me i diskutua me ekspertet ligjor me shikua që ky vendimi i jonë qe e marrim a mund te merret parasysh nga AKP-ja sepse për ndryshe AKP-ja është një farë pushteti ne kuadër të shtetit të Kosovës, mos të përsëritet rasti i Ferat Selimit me prona.

Isa Fejzullahi: Edhe unë jam qe çdo pronë me ja kthye Komunës, mirëpo pajtona me z. Salihu qe det pastrohet puna me AKP-në, me sa di unë Ferat Selimi është kontest gjyqësor dhe sipas informatave jo zyrtare e ka marr pëlqimin përmes negocimit për kthim direkt të asaj prone dhe nëse ne e kemi humbur një kontest ne vlerë 300 mijë € për një pronë dhe tash po dojme me ja marrë apët mos po sharrojmë apët si komunë?

Kryetari i Komunës z. Bekim Jashari: Të gjitha pronat qe janë kthye Komunës janë prona ne menaxhim të AKP-së jo të personave privat. Kjo prona ne shesh është nen menaxhimin e AKP-s, me fletë poseduese, kontesti për atë pronë është duke u bërë për fitimin e humbur qe ju ka shkaktuar personit privat, e jo për pronën. Të gjitha pronat ne komunën e Skenderajt qe janë nen menaxhimin e AKP-së jam

i interesuar me ja kthye të gjitha komunës së Skenderajt për të mirë të qytetareve të komunës ton dhe bashkërisht me vendos çka me bë me ato prona, qe ato prona mos me u shitë me çmim shumë të lirë.
Kryesuesja: Faleminderit kryetar, me kaq e mbyllim debatin për këtë pikë, konstatojmë me (28) vota për, (1) kundër, dhe (0) abstenim shtohet si pikë shtesë Propozim-vendim për shpalljen e zonës me interes publik ngastrën ne zonat katastralë Skenderaj dhe Klinë e Poshtme dhe bartjen e tyre ne pronësi të Komunës së Skenderajt. Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës e hapë debatin nëse nuk ka konstatojmë me (29) vota për, (0) kundër, dhe (0) abstenim miratohet Rendi i Ditës. Vazhdojmë me shqyrtimin e procesverbalit e hapë debatin nëse nuk ka konstatojmë me (29) vota për, (0) kundër, dhe (0) abstenim miratohet Procesverbali nga Mbledhja e Kaluar. Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës;
Raporti Financiar i Realizimit të Buxhetit Komunal Janar-Mars 2020, me nr.02-052/01-00145565/20, i dt.12.05.2020,(Raporton Drejtori për Buxhet dhe Financa z. Kastriot Gashi).
Drejtori për Buxhet dhe Financa z.Kastriot Gashi: Në përgjithësi buxheti i rep. Kosovës i vitit 2020 është karakterizua me vonës deri të miratimi i saj në muajn mars kur ka ndodh dekreti nga Presidenti të rep. Kosovës, kryesisht buxheti i komunës së Skenderajt për vitin 2020 pa bartjen e të hyrave është 14,950.500€, sipas kategorive të ndara si; Paga dhe mëditje 7,824.425€, Mallra dhe shërbime 1,650.640€, Shpenzime komunali 294,537€, Subvencione 300,000€, Shpenzime kapitale 3,773.140€ dhe Rezerva 1,107.758€. Rezerva ka pas për herë të parë në vitin 2020, MF e ka krijuar një fond për kategori të veçanta kategorinë e Rezervave, kjo është e lidhur direkt me Ligjin e Pagave dhe ne qoftë së miratohet ligji i ri i pagave atëherë këto mjete do të shfrytëzohet për të bërë pagesa dhe ne qoftë se nuk miratohet Ligji i ri i Pagave deri në muajin e 9 këto mjete ju kthehen komunës të projektet kapitale ose të ndonjë kategori qe ka nevojë komuna dhe deri në muajin e 9 këto mjete prej 1,107.758€ janë rezervë. Të raporti i ekzekutivit të buxhetit janar-mars 2020, janë; buxheti fillestar, aktual, alokimet, shpenzimet 2020, shpenzimet 2019, indeksi dhe progresi me alokime. Ne bazë të shpenzimeve ne krahasim me periudhën e njëjte të vitit të kaluar janë paraqitur, si Paga dhe mëditje 52%, Mallra dhe shërbime 11%, Shërbime komunale 2%, subvencione 2%, Investime kapitale 25% dhe Rezerva 7%. Të hyrat vetanake për vitin 2020 janë 1,528,014.00€ qe i bien 10% ne krahasim me grandin e përgjithshëm që është 13,422,486.00€ qe i bien 90%. Nëse i krahasojmë të hyrat e komunës janar-mars të vitit 2020 dhe i krahasojmë me vitin e kaluar të kësaj periudhën mundem me vërejte së të kategoria e tatimit në pronë kemi një rritje prej 35% të hyrave, gjithashtu tek kategoria e gjobave të bizneset nga inspektoratet kemi rritje të te hyrave. Fillimi janar-shkurt u kanë trend i mirë i realizimit të hyrave në nivel komune, po për shkak të paraqitjes së virusit Covid-19, d.m.th muaj mars, prill dhe maj ka pas renjë dhe po besoj qe ne qoftë se stabilizohet ekonomia trendi i të hyrave ka me pas rritje pozitive. Nëse ka dikush pyetje për shpenzime jam këtu për përgjigje.
Kryesuesja: Faleminderit drejtor, e hapë debatin, fjalën ja kaloj Azem Gashit, Albert Rexhepi, Musaj Hajdari, Vjollca Ramadani dhe Berat Dajaku;
Azem Gashi: Drejtor a banë me na dhënë me shumë sqarime të tabela kodet ekonomike; p.sh. Të Shërbimet kontratat tjera për vitin 2020 i kemi 52,979.76€ kurse për vitin 2019 i kemi 45,878.73€. Shpenzimet për anëtarësim për vitin 2020 i kemi 5,085.80€ kurse për vitin 2019 i kemi 2,168.85€, Pajisje tjera me pak së 1000€ për vitin 2020 i kemi 1,681.30€ kurse ne vitin 2019 i kemi 188.00€, shpenzimet për vendime të gjykatave për vitin 2020 i kemi 65,517.03€ kurse për vitin 2019 i kemi 4,127.33€, Avans për para të imta shuma 1000€ dhe Avans për udhëtime zyrtare shuma 2000€, a banë një sqarim ma shume drejtor?
Albert Rexhepi: Drejtor për projektin e kanalizimit ne BL- Qirez përkatësisht ne lagjen Muhaxher atje është duke u bërë ndotje e madhe me kanalizim dhe banoret ankohen qe të gjendet një zgjidhje sepse është shume shqetësuese ky problem për këta banorë.
Musaj Hajdari: Të shpenzimeve të vendimeve gjyqësore vlerë prej 65,517.03€, për çfarë konteste bëhet fjalë?

Vjollca Ramadani: Drejtor me dt. 11.03.2020 e kam dorëzuar një kërkesë për me ju ne ndihmua komuna grave lehona të paktën me një shumë 100-150€ pse nuk u shqyrtua ajo kërkesë, dhe perse nuk u përfshi ne buxhet?
Berat Dajaku: Të tabela numër 2 përqindja e kategorive ekonomike në pjesëmarrjen e buxhetit komunal viti 2020, 1% nuk po del askund a është gabim teknik a çka ka ndodhur me at 1% se nuk po del 100%?. Të projekti i kanalizimit ne Rakinic a ju ka bë pagesa ne segmentin e parë Kompanisë për kanalizimin në Rakinic?
Drejtori për Buxhet dhe Financa z. Kastriot Gashi: Azem, kodet ekonomike, të kategoria e shërbimeve kontraktuese tjera, vitin e kaluar sigurimi i objekteve, mirëmbajtja e objekteve është paguar nga kodi i mirëmbajtjes e objekteve ndërsa tash gjitha shpenzimet qe janë paguhen nga kategoria e shërbimeve kontraktuese. Të shpenzimet për anëtarësim është paguar anëtarësia e komunës në asociacionin e komunës dhe vlera prej 5,085.80€ është ne bazë të numrit të banorëve. Kategoria me pajisje me pak se 1000 të gjitha pajisjet qe i kanë ble drejtoret për nevojat e drejtorisë qe kanë kushtuar me pakë se 1000€ kjo kategori nënkupton për atë arsye. Avans për para të imta, zakonisht komunës ju ka aprovua me leje të MF se çdo vite aprovohet në avans për para të imta në vlerë prej 1000€dhe këto mjete shfrytëzohen për pagës me pakë se 1000€ qe nuk këna kontrata. Avansi për udhëtime zyrtare ne vlerë prej 2000€ këtë kategori e këna bë për shpenzimet e udhëtimet për me i pru 3 kamionë të zjarrfikëseve që na ka dhënë donacion shteti Gjerman përmes DSHP-së dhe këto shpenzime prej 2000€ janë shfrytëzua për këtë arsye. Shpenzimet për vendime të gjykatave e kemi një problem qe në qoftë së vendimi i gjykatës ne momentin qe vendimi i gjykatës është i formës të prerë shkon ne MF dhe e benë ekzekutohet e vendimeve të gjykatave. Të shtesat qe me i mbështet grat lehona e kam bisedua me Drejtorin për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, jam tu e përgatit KAB-in për vitin 2021-2023 dhe është hapësira për politika të reja qe në buxhetin e vitit 2021 me kanë ne buxhet ky projekt për shtesa për gra lehona.
Drejtoresha e Urbanizmit znj.Sanije Ahmeti: Për kanalizimi ne BL-Qirez jemi në dijeni edhe ma herët qe janë ne telashe me Kanalizim ajo Lagje mirëpo zyrtaret urbanizmit se bashku me nënkryetarin ka ndalur ne teren dhe kanë bisedua me banoret dhe ata kanë vendos se ku do të behet gropa për kanalizimin dhe atje kanë filluar punën dhe pritet me u zgjidhur ky problem. Kanalizimi ne Rakinic puna është duke vazhduar faza e pare dhe do të filloj edhe faza e dytë që ka mbetur me u shpallur edhe me përfundua komplet kanalizimi ne Rakinic sepse ka qenë ne dy faza. Edhe pagesa nuk është bë sepse nuk ka përfundua ende faza e parë.
Azem Gashi; Kryetar kur kanë me u përfshi ne ujësjellës fshatrat tjera si Buroja, Vojniku, Qubreli?
Kryetari i Komunës z. Bekim Jashari: Brenda një periudhe shume të shkurtër kanë me përfundua ujësjellësi edhe në fshatrat tjerë, po edhe nëse bëhet me ujësjellës fshatrat prapë këna me pas mungesë të ujët sepse nuk ka ujë të mjaftueshëm nga Mitrovica të fabrika ne Shipol deri sa nuk përfundon rezervari mbi fsh. Ternafc me bashkëpunim me ministrin dhe të vinë gypat dhe kur të përfundon ky projekt do te kemi ujë të mjaftueshëm.
Kryesuesja: faleminderit fjalën ja kaloj Beqir Veliu, Ismet Salihu dhe Pajazit Isufi;
Beqir Veliu: Gypi i ujësjellësit prej Kompleksit Memorial "Adem Jashari" qe shkon te Kompleksi Memorial i Dëshmoreve në Morinë a do të ishte mirë me u lidh banoret ne atë gyp për mos me bë shumë shpenzime?
Ismet Salihu: Drejtor të renta a banë sqarim pse është duke ndodh renta?
Pajazit Isufi: Drejtor buxheti nga të hyrat vetanake të komunës qe parashihen përafërsisht 1.400.00€ të jetë i bazuar ne buxhetin 14,950.500€ a do të thotë kjo qe janë do parashenja të dukshme qe të ketë madhësi të mëdha në përmbushjen e buxhetit dhe kriter e kisha bë të shpenzimet e druve bazuar ne vitin 2019 dhe vitin 2020 në periudha të njëjta kohore del që është një diference e shumes prej 30,000€ a do të thotë qe vitin e kaluar janë shpenzuar dru shumë apo sivjet janë harxhuar shumë pak.
Drejtori për Buxhet dhe Financa z. Kastriot Gashi: Në periudhën janar-mars të këtij viti dhe në periudhën janar-mars të vitit të kaluar kemi rritje prej 22.71% realizimin e të hyrave vetanake. Të tatimi

ne pronë vitin e kaluar për periudhën e njëjtë i kemi pas të realizuar 37.572€ këtë vite i kemi realizuar 50.789€ po foli për periudhën janar-mars me paraqitjen e pandemisë askush nuk ka ardhur me nxjerr vërtetime për tatim ne pronë, dhe nuk kemi mundur dikujt me i kërkua me pagua tatimin ne pronë, ku ligji ja lejon deri ne qershor. Nëse i krahasojmë në total të hyrat e komunës me vitin e kaluar ne total janë 8.7% me të mëdha për periudhën e njëjtë me vitin e kaluar. Të renta nëse arrimë me i grumbullua gjitha borxhet e vjetra qe shumë vjet qe janë grumbullua atëherë kemi realizuar edhe të hyrat qe jemi duke e bërë një plan të inkasimit të borxheve të vjetra, qe gjysma e vitit ka me pas trend pozitiv qe gjatë kësaj kësaj periudhe ka me pas problem me i paguar borxhet e vjetra ku pe dini situate ne te cilën jemi për shkak të virusit Covid-19. Pagesat qe janë bë vitin 2019 për dru nga kodi buxhetor me furnizim me dru janë 254,277.59€ ne vitin 2019 janë shpenzuar 159,952.59€ dhe vlera prej 94.275€ është borxhi bartur nga viti 2018, gjithashtu ne viti 2018 komuna e Skenderajt ka pasur 44.000€ shpenzime te qymyrit, ne vitin 2019 është nxjerrë një UA në Ministrin është ndaluar përdorimi i djegies së qymyrit dhe aj udhëzim na ka obligua qe me hapë tender në prokurim për dru dhe për atë arsye këna rritje të shpenzimeve të druve.

Kryetari i Komunës z. Bekim Jashari: Sa i përket gypit të ujësjellësit nga Kompleksi Memorial "Adem Jashari" ne Kompleksin memorial të dëshmoreve ne Marinë ky investim i ujësjellësit është investim i Agjencionit Memorialë në Kosovë nuk është investim i Komunës dhe aj gyp i ujësjellësit është ujë i pa përpunuar për ujitje për hapësira të komplekseve.

Kryesuesja: Faleminderit kryetar, fjalën ja kaloj Hysni Mehanit.

Hysni Mehani: Drejtor nëse ka mundësi me ma dhënë atë raport të druve ne formë të shkruar me pa qysh e ke arsyetua atë rritje kaq të madhe të druve.

Kryesuesja: Faleminderit, me kaq e mbyllim debatin për këtë pikë, konstatojmë me (22) vota për, 1) kundër, dhe (1) abstenim përkrahet Raporti Financiar i Realizimit të Buxhetit Komunal Janar-Mars 2020. Vazhdojmë me piken 5.

Raport i Zyrës së Prokurimit për muajit Janar-Prill 2020, me nr.03-052/01-0014227/20, i dt.05.05.2020, (Raporton Drejtori për Buxhet dhe Financa z. Kastriot Gashi),

Drejtori për Buxhet dhe Financa z. Kastriot Gashi: Materialin e keni marr me kohe, nëse keni pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: Faleminderit e hapë debatin, fjalën ja kaloj Hysni Mehani, dhe Isa Fejzullahu;

Hysni Mehani: Në KPF këtë pikë e ka raportua Hafseje Zejnullahu për me tepër kjo është konflikt interesi sepse drejtori i financave nuk bënë me u perzi ne punët e prokurimit. Me sa di Gazmend Berisha është në zyrën e prokurimit pse nuk vjen aj me raportua sepse me duket person i përgatitur, dhe nëse ju keni bë shkelje qe e keni dërgua ne zyre të prokurimit e po mundoni me mshef nuk u dashtë me emërua hiq. Drejtor Kastriot Gashi mos merr përgjithësi qe nuk mundesh me i majtë se me ta bë një pyetje për zyre të prokurimit nuk je ne gjendje me dhënë përgjigje.

Isa Fejzullahu: Në raportin e kaluar ka qenë një tender për zgjerimin e sallës se asamblesë çka po ndodh me atë tender.

Kryetari i Komunës z. Bekim Jashari: Sa i përket raportimit se pse po raporton Drejtori për Buxhet dhe Financa për zyre të prokurimit, është problem i imi kanë e autorizoj me raportua ne asamble. Gazmend Berisha ka shkuar me konkurs ne zyre të prokurimit dhe shef i Prokurimit është Hafseje Zejnullahi.

Drejtori për Buxhet dhe Financa z. Kastriot Gashi: Për projektin zgjerimi i sallës se asamblesë, tenderi hapët me 15 qershor është vonua procedura për shkak qe të barten mjetet qe e kemi bë ne mbledhjen e kaluar dhe aty është parapa zgjerimi i sallës se asamblesë.

Kryesuesja: Faleminderit me kaq e mbyllim debatin për këtë pikë, ne sallë janë 26 anëtar shkojmë në votim, konstatojmë me (24) vota për, 1) kundër, dhe (1) abstenim përkrahet Raport i Zyrës së Prokurimit për muajit Janar-Prill 2020. Vazhdojmë me piken tjetër.

Informatë për periudhën Janar-Prill 2020, lidhur me mirëqenien sociale, strehimi familjar, përkujdesja për të moshuarit, me nr. 08-052/01-0015493/20, e dt.21.05.2020, (Raporton Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z. Ibush Hetemi),

Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z. Ibush Hetemi; Përshëndetje për të gjithë, Informatën ne fjalë e keni marr me kohe, nëse ka dikush pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: Faleminderit, e hapë debatin, fjalën ja kaloj, Azem Gashi, Berat Dajaku, Hysni Mehani, Pajazit Isufi dhe Vjollca Ramadani;

Azem Gashi: Drejtor a banë sqarim të shtëpia e pleqve, cilat janë procedurat qe duhet me aplikua te janë pjesë e kësaj shtëpie, dhe a kanë përparësi banoret e Komunës tonë apo edhe komunat tjera?

Berat Dajaku: Të tabela e shërbimeve sociale ku shënon: Viktima të Dhunës Familjare i kemi 11 raste, dhe ne e kemi mbajtur një mbledhjen për mbrojtje dhe shpëtim dhe të pranishëm e kemi pasur një zyrtar të policisë dhe na ka tregua për gjendjen e sigurisë në komunën ton, dhe e kemi pyetur për raste gjatë kohës se pandemisë covid-19 dhe nuk kemi marr përgjigje prej ati zyrtari, këto 11 raste a janë raste të paraqitur ne polici a ne QPS?. Të prezantimi ne polici janë 14 a banë një sqarim çfarë prezantimi behet fjalë?. Të braktisja e shkollës janë 2 raste a janë braktisje ne shkollë fillore a ne shkollë të mesme?.

Hysni Mehani: Drejtor mu me është dërguar lista e pagave të punëtoreve të QKMF-së dhe në ato lista figuron emri i ish drejtorit të QKMF-së, a jeni ju ne dijeni Drejtor?

Pajazit Isufi: Ne bazë të periudhës 3 mujore duke e përjashtuar kohen e pandemisë a ka trend të rënies apo të ngritjes të numrit të familjes për asistencë sociale në komunën tonë?

Vjollca Ramadani: Pyetje; Ne seancën paraprake ke thënë qe është duke u përgatit një raport për banesat sociale, dua ta di çka ka ndodh me atë raport?

Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z. Ibush Hetemi: Pas dorëheqjes nga pozita drejtori i QKMF-së aj u kthye ne pozitën e mjekut dhe aj ne atë periudhë e ka pas emrin ne listën e pagave. Numri i familjeve sociale është tu ra për arsye sepse ato fëmijët qe fëmija po ja mbush pesë vjeç sipas ligjit qe e rregullon çështjen e asistencës sociale tërhiqen nga asistenca sociale. Shtëpia e pleqve ne Skenderaj nuk është e Skenderajt është regjionale dhe banorëve të Skenderajt i japim të drejt. Viktimat e dhunës ne familje për momentin janë 11 raste për periudhën janar-prill këto raste janë të regjistruar ne QPS dhe zakonisht raportohen nga policia. Prezantimi ne polici zakonisht përkthehet organi i kujdestarisë që është QPS-ja, ne çdo rast ku policia ka probleme me fëmijë nen moshën 18 vjeçare thirret punëtori social dhe aj punëtor është i obliguar me marr pjesë gjatë seancës të marrjes ne pyetje të fëmijës. Braktisja e shkollës i kemi 2 raste ka të bëjë me fëmijët e shkollës fillore në Mikushnices. Të banesat sociale jem në përfundim se perse ata persona e shfrytëzojnë banesën dhe pse ata nuk e kthejnë banesën ne çoftë se i kanë kushtet qysh ja ka paraqitur komisioni.

Kryesuesja: Faleminderit me kaq e mbyllim debatin për këtë pikë, konstatojmë me (23) vota për, (0) kundër, dhe (0) abstenim përkrahet Informatë për periudhën Janar-Prill 2020, lidhur me mirëqenien sociale, strehimi familjar, përkujdesja për të moshuarit. Vazhdojmë me piken tjetër;

Rekomandim i Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim, me nr. 01-060/01-0014981/20, i dt.18.05.2020, (Raporton Kryesuesi i Komitetit z. Berat Dajaku),

Kryesuesi i Komitetit z. Berat Dajaku: Komiteti për Mbrojtje dhe shpëtim ka mbajtur mbledhjen e rregullt me dt.15.06.2020 ne ora 14:00 dhe ne piken tre të kësaj mbledhje e qe ishte informatë nga Shërbimi i Zjarrfikëseve për zjarret ne komunën ton, dhe ne mbledhje u hapë debati për këtë pikë dhe komiteti mori vendim qe ti drejtohet me një rekomandim si ne vijim; Kërkojmë nga ekzekutivi komunal përkatësisht nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa që ti dalë ne ndihmë Shërbimit të Zjarrfikëseve në komunën tonë për rekrutimin e stafit prej 4 anëtareve të risi dhe plotësimin e nevojave në pajisje të këtij shërbimi (sipas mundësive buxhetore) të cilat do ti gjeni të bashkangjitura në këtë rekomandim të listuar nga shefi i Shërbimeve të Zjarrfikëseve z. Liman Geci.

Kryesuesja: Faleminderit Berat e hap debati, fjalën ja kaloj Vjollca Ramadani:

Vjollca Ramadani: Unë jam anëtare e Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim këtë kërkesë nuk e kanë votuar ne mbledhjen e komitetit, qysh e ceki kryesuesi, edhe pse unë kam dal ma herët nga mbledhja,

edhe nuk jam kundër qe mos me i ndihmua Shërbimit të zjarrfikëseve po unë jam qe kërkesa me u votua ne komitet dhe tani me u sjellë ne Asamble për miratim.

Kryesuesja: Faleminderit, me kaq e mbyllim debatin, konstatojmë me (16) vota për, (1) kundër, dhe (1) abstenim përkrahet Rekomandim i Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim. Vazhdojmë me piken tjetër;

Plani i Punës i Komitetit Këshillues për Arsim, Kulturë, Fe, Rini e Sport për vitin 2020, më nr.01-112/01-0000741/20, i dt.06.01.2020, (Raporton Kryesuesi i Komitetit z. Fadil Shaqiri),

Kryesuesi i Komitetit z. Fadil Shaqiri: Përshëndetje për të gjithë, ne mbledhjen e mbajtur me 07.02.2020 Komiteti Këshillues për Arsim, Kulturë, Fe, Rini e Sport ka hartua planin për vitin 2020, materialin e keni marrë me kohë kush ka pyetje ndonjë vërejtje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: Faleminderit, e hapë debatin nëse nuk ka, konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër, dhe (0) abstenim miratohet Plani i Punës i Komitetit Këshillues për Arsim, Kulturë, Fe, Rini e Sport për vitin 2020. Vazhdojmë me piken tjetër;

Plani i Punës i Komitetit Konsultativ për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore për vitin 2020, më nr.01-112/01-0013415/20, i dt.20.03.2020,(Raporton Kryesuesja e Komitetit znj. Fatmire Bajraktari),

Kryesuesja e Komitetit znj. Fatmire Bajraktari): Përshëndetje për të gjithë, Komitetit Konsultativ për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore ka hartua planin për vitin 2020, materialin e keni marrë me kohë kush ka pyetje ndonjë vërejtje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: Faleminderit, e hapë debatin nëse nuk ka, konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër, dhe (0) abstenim miratohet Plani i Punës i Komitetit Konsultativ për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore për vitin 2020. Vazhdojmë me piken tjetër;

Plani i Punës i Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2020, me nr. 01-112/01-0013248/20, i dt. 13.03.2020, (Raporton zv. Kryesuesi z. Fatmir Shaqiri),

Raporton zv. Kryesuesi z. Fatmir Shaqiri; Pasi ka munguar kryesuesi i komitetit do ta raportoj unë Planin e Punës se komitetit materialin e keni marr me kohe nëse ka dikush pyetje, vërejtjeje jam këtu për përgjigjet.

Kryesuesja: Faleminderit, e hapë debatin nëse nuk ka, konstatojmë me (20) vota për, (0) kundër, dhe (0) abstenim miratohet Plani i Punës i Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2020. Vazhdojmë me piken tjetër.

Plani i Punës i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike për vitin 2020, me nr. 01-112/01-0000967/20, i dt. 08.01.2020,(Raporton Kryesuesja e Komitetit znj. Vlora Gashi),

Kryesuesja e Komitetit znj. Vlora Gashi; Përshëndetje për të gjithë, Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike ka hartua planin për vitin 2020, materialin e keni marrë me kohë kush ka pyetje ndonjë vërejtje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: Faleminderit, e hapë debatin nëse nuk ka, konstatojmë me (20) vota për, (0) kundër, dhe (2) abstenim miratohet Plani i Punës i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike për vitin 2020. Vazhdojmë me miratimin e pikës shtesë;

Propozim-vendim për shpalljen e zonës me interes publik ngastrën ne zonat katastralë Skenderaj dhe Klinë e Poshtme dhe bartjen e tyre ne pronësi të Komunës së Skenderajt, me nr.05-463/01-0016078/20, i dt.28.05.2020, (Raporton Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronësi z. Ramiz Shala),

Drejtori i DGJKP-së z. Ramiz Shala: Ky propozim- vendim i propozohet asamblesë qe ngastrat kataastrale të cekura në këtë propozim-vendim për shpallur zona me interes publikë të cilat udhëhiqen në emër të titullarit të tyre qe gjenden ne Skenderaj dhe ne Klinë të Poshtme.

Kryesuesja: Faleminderit e hapë debatin, fjalën ja kaloj Naser Bajraktari;

Naser Bajraktari; Drejtor a banë me na tregu saktë ku gjenden këto ngastra?

Drejtori i DGJKP-së z. Ramiz Shala: Ngastrat ndodhen ne Skenderaj ne shesh dhe ne Klinë të Poshtme përball trafos.

Kryesuesja; Faleminderit me kaq e mbyllim debatin, konstatojmë me (20) vota për, (0) kundër, dhe (2) abstenim miratohet Propozim-vendim për shpalljen e zonës me interes publik ngastrën ne zonat katastralë Skenderaj dhe Klinë e Poshtme dhe bartjen e tyre ne pronësi të Komunës së Skenderajt, Vazhdojmë me pyetjet e këshilltarëve, fjalën ja kaloj Pajazit Isufi, Musaj Hajdari, Dorartan Ndreshaj, Isa Fejzullahi, Berat Dajaku, dhe Besarta Meha;

Pajazit Isufi: Pyetje: Drejtorisë për Bujqësi Pylltari dhe zhvillim Rural; **1.** A do të ndërmerrni ndonjë masë në eliminimin e qenve endacak në qytetin e Skenderajt pasi që janë duke paraqitur rrezik për jetën e qytetarëve? Kërkesë: Drejtorisë së Urbanizmit; **2.**Numer i konsideruar i banorëve nga Klina e Ultë dhe qyteza e Skenderajt kanë bërë kërkesë që në shtratin e lumit në vende të caktuara të vendosen shkallë për hyrje dhe dalje ne dhe nga lumë (nga shtrati i Lumit)?

Sokol Sallahu; Përshëndetje për të gjithë, DBPZHR-së ne bashkëpunim me AVU ka fillua projektin për trajtimin e qenve endacak, dhe nuk guxojmë me i eliminua ne pretekst, po të gjithë qenet qe janë të rrezikshëm për qytetaret ata do të eliminohen po jo ne preteks.

Drejtoresha e Urbanizmit znj.Sanije Ahmeti; Lumi ka nevojë për shkallë për hyrje dalje nga lumi dhe kemi me shti në projektet e ardhshme po për këtë vite nuk kemi buxhet.

Musaj Hajdari: Pyetje; **1.**A ka mundësi që ne rrugën 30 dhjetori të vendoset ndriçimi dhe të rregullohet trotuari i cili nuk ka përfundua ende edhe pse është ndërtua para 7-8 vite? **2.**A do të përfshihet fshati Klinë e Poshtme nga Projekti i ndriçimi ne qytet? **3.** A ka mundësi qe kurdo qe ne kuvende qe të na vije ndonjë parcele për këmbim, shpronësim ose forma tjera qe ato parcela ti identifikojmë përmes pamjeve, ose përmes numrave të parcelave-certifikatave nuk po kemi mundësi ti identifikojmë së për cilat parcela po bëhet fjalë?

Drejtoresha e Urbanizmit znj.Sanije Ahmeti; Për rrugën ne fjalë kemi bë kërkesë ne Agjencionin memorial ne Kosovë qe do të përfshihet komplet me ndriçim dhe me trotuar. Ndriçimi në qytet është i parapamë, po rruga ne Klinë të Poshtme nuk është e përfshinë dhe presim buxhetin e ardhshëm me përfshi.

Dorarta Ndreshaj: Pyetje; **1.** Drejtorisë Inspeksionit: Çfarë keni ndërmarr ju si drejtori kundër pirjes së duhanit nëpër hapësirat të mbyllur publike? **2.**Drejtorisë e Zhvillimit Ekonomik; Cilat zona i keni zgjedhur si zona turistike dhe çka keni ndërmarr për promovimin e turizmit në ato zona?

Kryetari i Komunës z. Bekim Jashari: Sa i përket zonave nuk i kemi caktuar ende zonat turistike jemi ne proces të hartimit të strategjisë për zhvillim të turizmit dhe ne bazë të ati procesi caktohen edhe ato zona turistike.

Isa Fejzullahu: Pyetje; 1. Për sa vite është me koncesion Qendra zejtare tek Stacioni i Autobusëve në Skenderaj? 2.Për sa vite është dhënë ndërtesa e ish objektit te stacion të vjetër të policisë dhe çka konkretisht ka përfituar komuna nga koncesioni?

Drejtoresha e Urbanizmit znj.Sanije Ahmeti; Qendra zejtare të stacioni i Autobusëve është dhenë për 99 vite. Për pyetjen e dyte seancën tjetër ta japë përgjigjen.

Berat Dajaku: Pyetje; Drejtorisë Urbanizmit: 1.Kur do të filloj asfaltimi i rrugës Rakinicë- Qubrel, rrugë kjo e cila ka kaluar nga planifikimi komunal ne ministri? 2.DSHP, Në fshatin Rakinicë rruga Besim Dajaku disa banor të kësaj rruge kanë kërkuar qe ti vendosen dy policë të shtrirë për shkak të siguris së fëmijëve të tyre, a ka mundësi drejtoria ti vendos apo jo?

Drejtoresha e Urbanizmit znj.Sanije Ahmeti; Rruga Rakinicë-Qubrel nuk ka kaluar ne planifikim buxhetor nga qeveria edhe pse na kanë thënë se vitin e kaluar q e ka hyrë ne buxhet?

Besarta Meha: Kërkesë; Banoret e lagjes Meha kane kërkesë për asfaltim te dy rrugëve; Gjate asfaltimit të rrugës në lagjen Meha i janë mbyllur dyert e hyrjes një mërgimtari nga kompania punuese. Vendosja e dheut në rrugë rreth një metër mbi nivelin e dyerve ja kanë pamundësuar qasjen në asfalt. Ky mërgimtar kërkon qe ti mundësohet qasja në asfalt dhe që është një mundësi nga pjesa e poshtme e rrugës. Kjo rruge nuk i krijon lidhje me asfalt vetëm këtij mërgimtari, por dhe disa shtëpive te tjera te cilat nuk kane dalje në rrugën kryesorë. Gjithashtu lagjja Meha kërkojnë qe ti mundësohet lidhja e asfaltit me lagjen Kodra. Kjo rruge do te lehtësonte qasjen me të shpejt në magjistralen Skenderaj-Drenas-Prishtinë. Jo vetëm lagjes Meha por dhe Prekazit te Epërm, Mikushnicës dhe Lubavecit. Si dhe te ua zvogëlonte kilometrat për banorët që kane destinacion këto fshatra. Me qenë se të dyja

janë rruge të shkurtra dhe së bashku bëjnë me pak se një kilometër. Cilat janë mundësit qe këtë rruge te behën pjese e planifikimeve buxhetore apo gjate rishqyrtimeve buxhetore?

Drejtoresha e Urbanizmit znj. Sanije Ahmeti; Sipas përfaqësuesit të lagjes pala pretendon se nuk ka pasur qasje dhe nuk është e mundur të bëhet sepse aty nuk ka pas qasje asnjëherë dhe hyrjen e ka nga ana tjetër e rrugës qe e shfrytëzojnë ajo pjesë e lagjes. Vetëm po pretendon qe e ka pas jemi ne ngjarje sepse kemi dal në teren. Lidhje me rrugën në lagjen meha me lagjen kodra do të shqyrtohet ne mundësi buxhetore.

Besarta Meha: Drejtoresh me qenë se keni dal ne teren aty keni mundur me pa do dyer të mëdhaja të zeza dhe ato dyer janë mbyllur sepse ja kanë pamundësua qasjen ne rrugë.

Kryesuesja: Faleminderit Besarta, me kaq e mbyllim takimin shihmi ne seancën tjetër.

Procesmbajtësi
Mujë Selmani

Kryesuesja e KK-së
znj. Fatbardha Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. No. 02-3/3/01-0018872/20
Data Data 12 06 2020

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 58 pika h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 50 pika h) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të dt.03.12.2008, vendimin Nr.01/11 të datës 15.03.2020, Kryetari i Komunës i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës në mbledhjen e rregullt të datës _____2020, këtë:

P R O P O Z I M - V E N D I M

Me qëllim të përkrahjes së bizneseve, fermerëve dhe OJQ-ve në rimëkëmbjen e tyre pas gjendjes emergjente të shkaktuar nga pandemia COVID-19, Kryetari i Komunës së Skenderajt propozon miratimin e pakos ekonomike emergjente, si në vijim:

1.Të lirohen nga pagesa me qira për periudhën e mbetur të vitit 2020 qiramarrësit e lokaleve afariste në pronësi të komunës;

2.Të gjitha bizneset në Komunën e Skenderajt, të cilat paguajnë taksë për shfrytëzimin e hapësirës publike, lirohen nga pagesa për periudhën e mbetur të vitit 2020 deri me 31.12.2020;

3.Sipas mundësive dhe hapësirave që posedon Komuna e Skenderajt do t'i mbështes OJQ-të lokale në sigurimin e hapësirave të punës në objektet publike;

4.Komuna e Skenderajt do të rrisë buxhetin për subvencione për bujqit për vitin 2021;

5.Komuna e Skenderajt do të rrisë buxhetin për subvencione në fushën e zhvillimit ekonomik, për vitin 2021.

6. Ky propozim – vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij në Kuvendin Komunal të Skenderajt.

ARSYETIM

Komuna e Skenderajt në përputhje me legjislacionin në fuqi, prioritetet dhe nevojat specifike të saj, ka krijuar këto masa mbështetëse që do të japin rezultatin më të mirë për rimëkëmbjen e ekonomisë lokale dhe do të ndikojnë në ngritjen e standardit të qytetarëve pa kompromentuar qëndrueshmërinë e financave publike si dhe kryerjen e funksioneve themelore në kompetencë të komunës.

Ju dërgohet:
1.Arkivit
2.Kryesueses së KK-së

REPUBLIKA E KOSOVËS • KOMUNA E SKENDERAJT • KRYETARI I KOMUNËS • REPUBLIC OF KOSOVO • MUNICIPALITY OF SKENDERAJ • PRESOEDNIK OPŠTINE

Kryetari i Komunës
Bekim Jashari

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. No. 02-400/01-0018819/20
Data Data 11-06-2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

KORNIZA AFATMESME E BUXHETIT 2021-2023

2020 Skenderaj

PËRMBAJTJA

KORNIZA AFATMESME E BUXHETIT 2021-2023 1
HYRJE 3
OBJEKTIVAT 2021-2023 5
KORNIZA FISKALE E KOMUNËS 7
STRATEGJIA ZHVILLIMIT EKONOMIKO LOKAL 8
ZHVILLIMI EKONOMIK 9
ARSIMI, KULTURA, RINIA E SPORTI 10
SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE 11
SHËRBIMET PUBLIKE 11
POLITIKAT E REJA 12
TË HYRAT BUXHETORE_PARASHIKIMI I TË HYRAVE KOMUNALE (TRANSFERET QEVERITARE, TË HYRAT VETANAKE) 13
BUXHETI I KOMUNËS SKENDERAJ PËR VITIN 2021 DHE VLERËSIMET PËR VITET 2022, 2023 SIPAS QARKORËS 2021/01 16
PLANI I TË HYRAVE PËR TRI VITET E ARDHSHME 17
BUXHETI 2021-2023 DHE SHPËRNADARJA E TIJ SIPAS KATEGORIVE EKONOMIK. 20
PROGRAMI I INVESTIMEVE PUBLIKE (PIP) 22
PERFORMANCA E DREJTORIVE TË KOMUNËS 25
ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS 25
KUVENDIT KOMUNAL 27
ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM 27
DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME 28
DREJTORIA PËR BUXHET E FINANCA 30
DREJTORIA PËR GJEODEZI KADASTËR DHE PRONË 32
DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBANË DHE MBROJTJE TË MJEDISIT 33
DREJTORISË PËR BPZHR 37
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT 38
DREJTORIA PËR ARSIM 43
DREJTORISË PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENJE SOCIALE 45
DREJTORIA E INSPEKSIONIT 47

Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore si strategji dhe metodologji e Bankës Botërore është rekomanduar dhe aplikuar për herë të parë në Lituani në fillim të tranzicionit të saj në vitin 1990. Qëllimi i ofrimit të këtij dokumenti startegjik ishte t'ju lehtësojë punën vendimarrësve për marrjën e vendimeve në kohë më të shkurtër për investime dhe shpenzime të parasë publike në mënyrë efikase dhe efektive.[1]

Korniza Afatmesme Buxhetore e komunë sonë paraqet dokumentin kryesor nga i cili do të hartohet buxheti për vitin 2021. Ky dokument tregon caqet e përgjithshme të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike dhe programeve për t'i përmbushur objektivat e përcaktuara nga Strategjitë zhvillimore komunale.
Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB), që po prezantojmë është një dokument i cili azhurnohet dhe miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe të hyrave dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor dhe vlerësimet për dy vitet në vijim. Gjithashtu, KAB siguron mekanizmat e nevojshme përmes të të cilave objektivat prioritare të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.
Hartimi i kornizës bazohet në :

- Ligjin për financat e pushtetit lokal;
- Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë;
- Ligjin për vetëqeverisjen lokale;
- Ligjin për kufijtë administrativë komunalë;
- Ligjin e buxhetit dhe
- Qarkorja Buxhetore 2021/01 e lëshuar nga Ministria e Financave

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve dhe të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2021-2023.

[1] Majk Stivens (MTEF " Medium Term Expensive Frameworks") Banka Botërore 1996

KAB-i gjithashtu do të shërbejë si pika kryesore e referimit me rastin e hartimit të buxhetit për vitin 2021 dhe vlerësimet për dy vitet e ardhshme .

Janë tri faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB-it Komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:

PROFILI I KOMUNËS SË SKËNDERAJT

Komuna e Skenderajt për nga sipërfaqja ka vetëm 374 km², por që është e njohur që në antikitet. Runiku, lokalitet ky i neolitit të hershëm dhe të ri, kalaja antike mesjetare e Syriganës dhe fortfikata 'Gjytet ikl madh" në Tushillë, lokalitet "varreza e vjetër' në Açarevë etj,dëshmojnë për civilizimin e hershëm të kësaj zone të shtrirë në qendër të Drenicës. Ndërsa një sërë gjurmësh të kishave, ndër to edhe të asaj paleokristane në Izbicë, apo atyre të tjerave në Runik, Leçinë, Rezallë etj., së bashku me monumente të tjera të shumëta arkeologjike flasin për kontinuitetn iliroarbëror dhe vazhdimin e mbetjes së kësaj zone si pikë e banueshme me histori, kulturë e traditë edhe përgjatë shekujve në vazhdim.

Regjistrimet e fundit të popullsisë në Kosovë shënojnë 50,858 banorë rezidentë në këtë komunë, ndërsa është interesante se prej këtj numri të gjithmbarshëm 63% i takojnë grupmoshës së aftë për punë nga 15 – 64 vjeç. Kështu vetëm reth 7 % e banorëve janë të moshës mbi 65- vjeçare.

Bujqësia është një nga aktvitetet më të rëndësishme të Skenderajt pasi konsiderohen të jenë jenë rreth 21,149 ha tokë apo 57% e sipërfaqës së territorit të komunës së Skënderajt, prej së cilës shumica është tokë e punueshme me një pjesë të vogël e destinuar për kullosa. Ndërsa sipërfaqe pyjore janë rreth 14, 685 ha apo 39 % përderisa rreth 1,606 ha e tokës është djerrinë[2].

Biznesct kryesisht janë ndërmarrje bujqësore, prodhuese, ndërtimore, hoteliere, transportuese, tregtare dhe shërbyese.Tregtia është një nënsektor tjetër ekonomik që ka pasur një zhvillim të hovshëm gjatë një kohe shumë të shkurtër. Sipas të dhënave të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik , nga komuna e Skenderajt, deri më tani janë regjistruar 3.329 biznese në Skenderaj, nga to, rreth 2.596 janë aktive, rreth 733 sosh të shuara . Një analizë e aktviteteve të tyre biznesore si veprimtari, rreth 42 % janë tregti, rreth 10 % hotelieri e gastronomi, afër 9 % autoservise, me nga 5 % janë nga sektorët sallone ondullimi, prodhimtari, mjekësi e veterinë dhe ndërtmtari, e tjerat aktvitete janë shumë të vogla si përqindje (1-3 %).

OBJEKTIVAT 2021-2023

Është e qartë tashmë se dokumenti Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) si një version i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), ka të përcaktuara edhe objektivat e saja, pra si qëllim kryesor ka krijimin e bazës për përgatitjen e buxhetit në këtë rast buxhetin për tri vitet e ardhshme 2021-2023, gjithashtu përkufizon kufijtë e shpenzimeve buxhetore për tri vitet e ardhshme dhe vënë kontekstin e vendosjes së shpenzimeve në sektor të caktuar.
Korniza Afatmesme Buxhetore 2021–2023 si objektiv të sajën gjithashtu ka edhe arritjen e qëllimeve të cilat padyshim se janë në funksion të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve tanë duke përcaktuar prioritetet zhvillimore dhe duke vendosur një planifikim buxhetor stabil, e cili do të sigurojë realizimin e tërësishëm të tij.

[2] Drejtoria e Bujqësisë Skenderaj

Objektivat e KAB komunal janë:

- Hartimi i një procesi të mirëfilltë buxhetor nga i cili do të rezulton një projeksion buxhetor i qëndrueshëm;
- Zhvillimi, promovimi dhe rigjenerimi infrastrukturës në të gjitha sferat e saja;
- Të sigurohet një planifikim real i shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore;
- Zhvillimi ekonomik, në të gjitha fushat,
- Përmirësimi i ambientit për të jetuar, arritja e standardeve;
- Avancimi i shërbimeve shëndetësore;
- Avancimi i zhvillimit të sistemit arsimor;
- Avancimi i zhvillimit të kulturës dhe sportit;
- Përkrah dhe ndihmojë zhvillimin e biznesit;
- Subvencionimet në bujqësi;
- Mirëmbajtja e hapësirave publike;
- Intensifikimi i kërkesave për përkrahje nga niveli Qendror etj.

Objektivat e Qeverisë :

Objektivat kryesore të Programit të Qeverisë 2021-2023 theksojnë se prioritetet e Qeverisë duhet të fokusohen në këto fusha:

i) Drejtësi;
ii) Ekonomi dhe Punësim;
iii) Arsim;
iv) Shëndetësi;
v) Siguri;
vi) Integrime euro-atlantike; dhe
vii) Mjedis.

KORNIZA FISKALE E KOMUNËS

Konform përcaktimeve ligjore çdo organizatë buxhetore ka kornizën e saj fiskale mbi bazën e së cilës krijon të hyrat vetanake si njëra ndër burimet e financimit të buxhetit të Komunës. Seksioni mbi kornizën fiskale përbën elementin e parë të procesit që të çon në drejtim të përcaktimit të objektivave fiskale të komunës për periudhën e tri viteve të ardhshme.

Pra edhe pse komuna nuk e udhëheq drejtpërdrejt politikën makroekonomike, mjedisi i përgjithshëm ekonomik do të ndikojë në pasqyrën fiskale të komunës dhe si i tillë duhet trajtuar në këtë kornizë. Komponentët e politikës makroekonomike siç janë BPV pastaj inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasyshë komuna në parashikimet e saj fiskale. Në këtë drejtim komuna duhet të shqyrtojë mundësinë e rishikimit të politikës apo kornizës fiskale të komunës aty ku vlerësohet se ka hapësirë, duke ndërhyrë në rregulloret e brendshme të cilat do të jenë padyshim në funksion të rritjes së efikasitetit dhe të ardhurave të bizneseve, po ashtu rritje të trendit të hyrave vetanake.

Tabela 1: Indikatorët ekonomik komunal

Përshkrimi	*2020(aktual)*	*2021*	*2022(vlerësimi)*	*2023(vlerësimi)*
Indikatorët makroekonomik në Kosovë				
Rritja reale e BPV në %[3]	-2.1%	5.4%	4.1%	4.0%
Inflacioni në %	0.9%	2.0%	1.8%	1.8%
BPV për kokë banori, në €	3,951	4,248[4]	4,496	4,756
Indikatorët ekonomik komunal				
Popullsia e Komunës	50,858	51,028	51,227	51,369
Numri i bizneseve aktive që janë duke operuar	564[5]	600	650	700
Numri i nxënësve	10,920	10,093	10,999	11,103

Gjithashtu prej ketij viti është duke u punuar në impelmentimin e Ligjit te ri për Tatim në pronë i cili ligj ka hyrë ne fuqi dhe do te perfshijë edhe tatimin në tokë, pra perveq tatimit në objekte do të fuqizohet edhe ky lloji i tatimit gjate periudhës 2021-2023.

[3] KASH 2021-2023 faqe 86
[4] Bruto Prodhim Vendor /për numrin e banorëve
[5] BIznese qe operojnë në mënyrë active- Drejtoria pë Zhvillim ekonomik

Me Qarkoren Buxhetore 2020/01 komuna jonë ka pranuar kufijt fillestar të financimit për Buxhetin e vitit 2020 si dhe vlerësimet 2021 dhe 2022, në kuadër të cilit ne kemi edhe planifikimin e të hyrave vetanake të bazuar në parametrat fiskal si dhe në performancën e inkasimit të kërkesave në të gjitha llojet e të hyrave.

STRATEGJIA ZHVILLIMIT EKONOMIKO LOKAL

(prioritet strategjike zhvillimore)

Komuna jonë veq e ka të hartuar dokumentin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2019-2023 si një projekt tejet i rëndësishëm për projektimin afatmesëm të zhvilimit të komunës sonë. Megjithate trajtimi i SZHL në përmbajtjën gjenerale të dokumenti i- KAB-it është mëse i domosdoshëm. Pra është e domosdoshmëri që çdo organizatë buxhetore të veprojë brenda një kornize të përgjithëshme (plani strategjik), në të cilën përcaktohen politikat dhe prioritetet afatgjata dhe afatmesme. Korniza Afatmesme Buxhetore shërben si një mjet për të trajtuar prioritetet e konsumit buxhetor të planeve të zhvillimit strategjik të cilat do të përfshihen në buxhetin e komunës për të realizuar atë gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare, 2021-2023.

Një prej çështjeve më të rëndësishme në kuadër kornizës afatmesme buxhetore është vendosja e prioriteteve zhvillimore duke pasur parasyshë parimin e kontinuitetit në investime kapitale me kornizën buxhetore 2021-2023.

Vizioni i Komunës:

Komuna e Skenderajt promovon qytetari mikëpritëse, jetë dinamike, ekonomi gjithë përfshirëse dhe identitet kulturor kombëtar.

Misioni:

Komuna e Skenderajt do të kontribuon në krijimin e kushteve për zhvillim dhe ekonomi konkurruese e gjithëpërfshirëse duke mbështetur sektorët primar vendor dhe duke punuar me të gjithë bashkarisht për realizimin e vizionit të komunës.

Prioritet Komunale :

Janë të identifikuara katër prioritetet e përgjithëshme zhvillimore të KAB të cilat burojnë nga Strategjia e Zhvillimit ekonomik lokal e që janë:

- Zhvillimi ekonomik, përfshirë të gjitha degët e saja,
- Arsimi, kultura, rinia e sporti;
- Shëndetësia dhe mirëqenia sociale;
- Shërbimet publike.

1. ZHVILLIMI EKONOMIK

Objektivi parësor i qeverisë sonë lokale mbetet zhvillimi ekonomik, komponentë zhvillimore e cila mundëson arritjen e realizimit të misionit institucional i cili ka të bëjë me ngritjen e mirëqenies qyetare. Komuna ka hartuar dhe ka aprovuar **"Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2019-2023"**, në të cilin dokument kemi analizat mbi mundësitë dhe pengesat zhvillimore, pastaj prezentimin e potencialeve (resurseve) tona natyrore, si dhe synimet dhe objektivat afatmesme zhvillimore përfshirë të gjitha lëmitë ekonomike. Pra dokumenti Strategji e Zhvillimit Ekonomik Lokal do të ndihmon dhe lehtëson edhe përcaktimin e prioriteteve zhvillimore si dhe do të jetë bazë e planifikimeve buxhetore për periudhën e vlefshmërisë së tij.

Institucionet qendrore nëpërmjet zhvillimit të projekteve kapitale, çdo vit fiskal kanë kontribuar në zhvillimin ekonomik të komunës, në mënyrë indirekte, gjithashtu kanë krijuar infrastukturë të volitshme ligjore si ndihmë e drejpërdrejtë e sektorin privat si një promotor i zhvillimit ekonomik në kushtet e ekonomisë së tregut. Orientimet zhvillimore për këtë periudhë do të jenë të fokusuara në zhvillimin e bujqësisë dhe degëve të saja, pastaj në ngritjen infrastrukturore për krijimin e zonës ekonomike, sepse atë e garantojnë mundësitë buxhetore, pasi që investimet kapitale në lëminë e infrastruktures së përgjithëshme do të përmbyllën pothuajse në përqindje të lartë.

Kryetari i Komunës mbështetur në kompetencat ligjore, mbrenda kësaj kornize buxhetore do të azhurnojë politikën fiskale dhe sigurisht se edhe do të ndryshojë atë gjithnjë në favor të

bizneseve duke krijuar lehtësira edhe më të mëdha drejt tërheqjës së investimeve të huaja në komunën tonë. Formimi i drejtorisë "*Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion e Turizëm* " do të jetë një vegël e fuqishme në drejtim të këtij synimi.

2. ARSIMI, KULTURA, RINIA E SPORTI

Gjatë periudhës së azhurnimit të kësaj kornize buxhetore, institucionet tona lokale do të vazhdojnë në avansimin e mëtejm të kushteve infrastrukturore të sistemit arsimor, e cila padyshim se do të ndikojë në ngritjën edhe të mëtejme të cilësisë e sukseseve tjera në këtë sistem.
Viteve të fundit në sistemin arsimor të Skenderajit është bërë mjaft, në fushën e ndërtimit të objekteve të reja shkollore, renovimeve, trajnimit të personelit arsimor por mbetet në vazhdimësi të investohet edhe më tutje në rinovimin e shkollave, ndërtimin e fushave sportive, instalimin i sistemit të nxemjeve qendrore në nivel të gjitha shkollave, sigurimi i rrethojave të shkollave, pajisja e shkollave me mjete të teknologjisë informative, kabinete, mjete konkretizimi etj.

Nga ajo që u potencua më lart kuptohet se mbrenda kësaj kornize institucionet tona qeverisëse, duhet planifikuar mjete buxhetore për të realizuar shumë projekte kapitale për të kompletuar objetet përcjellëse në shkolla. Por zvoglimi i grantit specifik të arsimit për 6.56% krahasuar me vitin aktual 2020 përshkak të pasojave qe ka prodhuar Coronavirusi ku kemi rënie të planifikuar të BPV për vitin aktual -2.1% dhe zvoglimi i 2.96% i Grantit te përgjithshëm komunal i cili nuk garanton edhe përkrahje aq të madhe. Duke pasur parasysh prioritetin e komunës për Sektorin e Arsimit mbetet alternativë financimi nga të hyrat vetanake komunale, niveli qendror dhe donatorët eventual.

Komuna edhe gjatë vitit aktual fiskal e ka të realizuar integrimin e komunitetit (fshati Banjë me banorë kryesisht serb) në kuadër të arsimit parafillor, me staf prej 8 vetash sipas marreveshjës së Kryetarit të Komunës me perfaqësuesin e Zyrës Komunale për komunitete dhe kthim. Ky komunitet është integruar në pajtueshmeri të plotë me sistemin dhe organogramin komunal të qasjës në buxhet duke respektuar LMFPP-në dhe Ligjin e vetëqeverisjes lokale dhe duke dhenë përgjegjësi për raportime financiare (shpenzimi i buxhetit , krijimi i THV-ve sipas rregulloreve komunale).

3.SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE

Sistemi shëndetësor primar në komunën tonë pothuajse në shumë segmente të tija gjatë viteve të fundit është kompletuar dhe se si i tillë tani më garanton ngritje të performancës në shërbime shëndetësore për qytetarët tanë. Gjatë tërë kohës sa po zgjatë pandemia e Corona-virusit shëdetësia primare komunale po japë rezultate shumë të mira në ruajtjën dhe përkujdesin e shëndetit të banorëve të komunës sonë. Qendra e re e Mjekësisë Familjare është duke ofruar kushte teknike dhe infrastrukturore për shërbime cilësore.

Gjithashtu modernizimi i QKMF-së dhe qendrave familjare me pajisje mjekësore në të gjitha objektet shëndetësore po jep rezultatet e saj. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqnie Sociale është duke rritur aktivitetin e saj edhe më sferën e shërbimeve përmes projekteve siq është programi "Kujdesi shtëpiak", do të planifikojë gjithashtu ngritjen buxhetore për të avansuar edhe më tej efikasitetin e shërbimeve shëndetësore, pastaj ngritjen buxhetore për ndihmë financiare dhe atë të strehimit për raste sociale. Sfidë mbetet kompletimi i vazhdueshem me pajisje të nevojshme mjekësore dhe më autoambulanca dhe aparate labaratorike, autovetura të përshtatshme për ofimin e kushteve për përsonat në hemodializë etj. Meq buxheti i planifikur për vitet në vijim parshihet të jetë më i madh sigursht qe komuna do të ketë mundësi reale për realizimin e synimeve të saja.

4. SHËRBIMET PUBLIKE

Komuna jonë në lëminë e shërbimeve publike qëndron në situatë relativisht të mirë, pasi që gjatë këtyre viteve në fushën e shërbimeve publike janë bërë investime të mëdha, sidomos në lëminë e infrastrukturës rrugore, ndriçimin e qytetit, gjelbërimin e qytetit, shtratin e Lumit Klina që përshkon qytetin, ka filluar faza e kanalizimeve edhe në zonat rurale, ujesjellësave dhe investime tjera të nevojshme për komunitetin e komunës sonë. Megjithate në këtë fushë ka edhe shumë për t'u bërë. Komuna ka berë edhe një përparim në bashkëpunim më Kompaninë "Uniteti" në drejtim të eliminimit të deponive ilegale. Sfidë do të jetë mirëmbajtja dhe kujdesi ndaj këtyre investimeve të bëra, sidomos mirëmbajtja dhe ruajtja e hapsirave publike. Megjithate, Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023 padyshim se do të përmbajë më shumë investime të cilat do të avancojnë edhe më shumë ngritjën e efikasitetit të shërbimeve publike, si një mision i institucioneve tona.

POLITIKAT E REJA

Politikat e reja te cilat parashikohen te impementohen gjate kësaj periudhe 2021-2023 duke mos u kufizuar vetëm ne këto politika.

- **Shërbimet Publike komunale**
  - Gjatë përidhës 2021-2023 komuna parasheh qe të ketë edhe të hyrave vetanake komunale edhe nga inkasimi i shërbimeve nga grumbullimi i mbeturinave nga qytetarët e komunës e cila do të realizohet përmes një Memorandumi Mirëkuptimi në mes të Komunës dhe kompanisë për manaxhimin e mbeturinave "Uniteti" dhe shuma e inksimit të planifikuar do të jetë 250,000.00 dhe
  - Krijimi i nënprogramit për zjarrëfiksat e komunës gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2021-2023

- **Në Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:**
  - Nga viti 2021 komuna planifikon që mënyrë institucionale të përkrahë të gjitha lehonat e komunës nga kategoria e subvencione për çdo lindje të fëmijëve si mbështetje për gratë si shtyllë kryesore e familjës dhe shtetit. Sipas të dhënave nga sektori i gjendjës civile komunale mesatarisht numri lindjeve në vit janë 900 lindje. Kosto e përgjithshme e financimit planifikohet të jetë 90,000.00 €
  - Të shtëpia Rezidenciale për shkak të rritjës së kërkesave në nivel regjional për strehim të moshuarve pa përkujdesje familjare komuna planifikon qe të rritë numrin e rezidentëve edhe për katër dhe poashtu konform rritjës së numrit të strehuarve do të rritë edhe numrin e stafit për një të punësuar dhe kostoja e tij do të jetë do të jetë 7,200.00 vjetore. Kosto totale e Qendrës do të rritet në total 17,200.00€.

- **Në sektorin e Zhvillimit ekonomik dhe të bujqësis**
  - Në të dy programet komunale në Bujqësi dhe programin e Zhvillimit Ekonomik do të vazhdojë përkrahja e farmereve me makineri përcjellëse bujqësore, koshere të bletëve, serra, pemë dhe perime etj. Kurse tek programi i ri përmes "Start Up" programeve do të përkrahen bizneset e vogla dhe të mesme përmes memorandumeve bashkëpunimi por dhe përmes thirrjeve publike për subvencione.

TË HYRAT BUXHETORE

Parashikimi i të Hyrave Komunale (Transferet Qeveritare, të Hyrat Vetanake)

Ne kuadër te Kornizës Afatmesme te Shpenzimeve te Qeverisë se Republikës së Kosovës përcaktohen grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2021 dhe orientimet për vitet 2022-2023, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, ky dokument përcakton nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2021 si dhe parashikimin afatmesëm 2022-2023.

Kurse parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2021, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën nr.1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave dhe Transfereve siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Burimet e Financimit Komunal për vitin 2021-2023

Granti i Përgjithshëm [6]

Korniza Afatmesme Buxhetore përmban analizën me përmbajtje mbi segmentin e parashikimit të të hyrave buxhetore prej të dy burimeve të financimit por me fokus të hyrat vetanake pasi që totalet e granteve qeveritare janë të përcaktuara sipas formulës qeveritare të zbatuar nga Komisioni i Granteve. Ashtu siç theksuam edhe më lart Qarkorja Buxhetore 2020/01, karakterizohet me zbatimin e rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, kritereve për shpërndarjen e Grantit të Përgjithshëm si dhe kritereve për Grantin Specifik për Arsim e Shëndetësi te cilët mbështetën në qasjen me sistem të hapur sipas LFPL të financimit.

Bazuar në të dhënat nga Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar të Ministrisë së Financave dhe Transfereve në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2021 është aprovuar në shumë prej 190.49 milion euro.

[6] KASH 2021-2023

Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, duke përjashtuar: mbështetjen buxhetore dhe grantet, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, i cili grant për vitin 2021 është në shumë prej 190.49 milion euro. Të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2021 pritet të jenë 2,006.8 milion euro.

Tabela 1: Përcaktimi i vlerës së Grandit të Përgjithshëm për komuna 2021-2023 (mil. Euro)

Përshkrimi	**Viti 2018**	**Viti 2019**	**Viti 2020**	**Vitit 2021**	**Viti 2022**	**Viti 2023**
A. Të Hyrat e përgjithshme të Qeverisë	1,896.0	1,920.3	2,060.5	2,006.80	2,125.80	2,255.3(
Zbriten:			-	-	-	-
Te hyrat e dedikuara	(50.00)	(9.20)	-	-	-	-
Mbeshtetja buxhetore dhe grante	(5.00)	(5.00)	(10.50)	(10.50)	(10.50)	(10.50)
Tatimi në pronë	(30.00)	(30.00)	(33.20)	(37.20)	(40.10)	(42.90)
Të hyrat nga dividenta	(5.00)	-	-	-	-	-
Grantet e percaktuara të donatorëve	(12.00)	-	-	-	-	-
Taksa ngarkesa dhe të tjera nga Qeveria lokale	(52.00)	(57.00)	(50.00)	(50.00)	(50.00)	(50.00)
Të hyrat e njëhershme nga borxhet	(6.00)	(8.00)	-	-	-	-
Të hyrat nga interesi		(4.20)	(4.00)	(4.20)	(4.20)	(4.20)
B. Baza për llogaritjen e grantit të përgjithshëm për komuna	1,736.00	1,806.90	1,962.80	1,904.90	202.10	2,147.7(
C. Granti I përgjithshëm për komuna (10%)	173.60	180.69	196.28	190.49	202.10	214.77

Sipas Qarkores në tabelën në vijim mund të vëreni se Granti i Përgjithshëm (5,231,032.00) ka pësuar rënje 2.96% nga buxheti i aprovuar 2020, Granti për Arsim (5,712,526.00) ka një rënje 6.56% nga buxheti i aprovuar 2020 edhe pse janë kalkuluar politikat e reja.[7] Kurse Granti për Shëndetësi (1,775,198.00) ka shënuar ngritje prej 2.11 %. Edhe në këtë vit vazhdon transferi i kompetencave nga niveli qendror për Shërbimet Rezidenciale (185,000.00) ka shënuar ngritje prej 2.78 %. Plani i të hyrave vetanake komunale ka mbetur i pandryshuar me vitin aktual pra 1,528,014.00. Në total buxheti për vitin 2021 nga të gjitha burimet është më i vogël për -3.47% nga viti aktual.

[7] Paga jubilare sipak kontrates kolektive,paga per parafilloret femijet 2-5 vjeq , mallrat dhe sherbimet per femijet 4-5vjeq dhe kosto e pageses se procedurave per validim dhe akreditim per shkola te mesme dhe profesionale

Kufijtë e grumbullimet e të të hyrave vetanake komunale janë tepër optimiste gjë që do të krijoj hapsirë të pamjaftueshme për realizimin në tërësi të tyre. Të hyrat nga grumbullimi i obligimeve nga faturat për shërbimet e mbeturina prej 250,000.00 € do ta zbut pak planin e grumbullimit të hyrave.

Të hyrat e planifikuar për vitin 2021 nga të gjitha burimet e financimit për programet specifike dhe krahasimi i tyre me vitin aktual 2020 është prezantuar në tabelën në vijim së bashku me diferencat e shprehura në shuma dhe përqindje.

Fondet Burimore	Viti 2020	Viti 2021	Diferenca 2021-2020	Diferenca ne %
Granti i përgjithshëm	5,390,499	5,231,032	-159,467.00	-2.96
Granti për arsim	6,113,402	5,712,526	-400,876.00	-6.56
Granti për shëndetësi	1,738,586	1,775,198	36,612.00	2.11
Transferi i Shërbim. Rezide.	180,000	185,000	5,000.00	2.78
Gjithsej të hyrat vetanake	1,528,014.00	1,528,014	0.00	0.00
GJITHSEJ TË HYRAT	14,950,501.00	14,431,770.00	-518,731.00	-3.47

Grafiku i buxhetit – raporti i vitit 2021/2020 sipas te gjitha burimeve të financimit



BUXHETI I KOMUNËS SKENDERAJ PËR VITIN 2021 DHE VLERËSIMET PËR VITET 2022, 2023 SIPAS QARKORËS 2021/01

Qarkorja Buxhetore e Ministrit të financave përveq kufijve për vitin e ardhshëm fiskal ajo jep informacione dhe për vlerësimet për dy vitet buxhetore 2022-2023 ashtu siq është prezantuar në tabelë:

Burimet e Financimit	Viti aktual 2020	Buxheti 2021	Vlerësimet 2022	Vlerësimet 2023
Granti i përgjithshëm	5,390,499.00	5,231,032.00	5,550,519.00	5,899,177.00
Granti për arsim	6,113,402.00	5,712,526.00	6,202,980.00	6,229,242.00
Granti për shëndetësi	1,738,586.00	1,775,198.00	2,607,180.00	2,620,216.00
Transferi i Shërbim. Rezide.	180,000.00	185,000.00	185,000.00	185,000.00
Gjithsej grandet	**13,422,487.00**	**12,903,756.00**	**14,545,679.00**	**14,933,635.00**
Të hyrat vetanake	1,528,014.00	1,528,014.00	1,727,656.00	1,759,151.00
GJITHSEJ TË HYRAT	**14,950,501.00**	**14,431,770.00**	**16,273,335.00**	**16,692,786.00**

Përveq të hyrave nga Grandi i Përgjithshëm, Grandi për Arsim dhe Shëndetesi të cilat ju nënshtrohen kriterëve të caktuar specifik për ndarje, komuna ka në dispozicione edhe të hyrat vetanake të cilat realizohen në bazë të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal , Rregullorës së brendshme mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Ligjin mbi Tatimin në Pronë, Rregullores Komunale për ngarkesat dhe taksat si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktojë dhe inkasojë, por se kemi edhe të hyra tjera të cilat nuk bazohen në rregulloren tonë siç janë të hyrat nga gjobat në trafik, gjobat e gjykatave dhe rrjedhin nga niveli qendror.

Edhe pse trendi i të hyrave vetanake në komunën tonë pothuajse vit pas viti ka shënuar progres, Administrata e Komunës respektivisht Drejtoria për Buxhet e Financa, do të trajtojë me kujdes burimet e mundëshme të hyrave, të studioj dhe analizoj me kujdes kornizën fiskale të komunës në mënyrë që të bëjë eliminimin edhe të atyre pengesave të cilat do të mundë të rrezikonin ecurinë pozitive të të hyrave vetanake.

Tatimi ne pronë është i vetmi tatim që arkëton komuna dhe është një prej burimeve kryesore të hyrave vetanake. Kjo e hyrë i kthehet qytetarit në mënyrë indirekte në projekte. Të hyrat nga Tatimi në Pronë rrjedhin nga pasuria individuale e qytetarëve. Numri i tyre të regjistruara dhe të modifikuara deri me tani është 11611 prona në total, por 2345 prona për shkak të vlerës se ulët (deri 50m^2) nuk kanë bazë tatimore.

Synimet e Drejtorisë janë që gjatë tri viteve të ardhme të përfshihen të gjitha pronat e pa regjistruara për qëllime të Tatimit në Pronë dhe ndryshimet eventuale në pasuritë e regjistruara. Numri i tyre pritet të jetë 400, me bazë tatimore, që në total planifikojmë një të hyrë vjetore në shumë prej 314,466.00 € s'bashku me tatimin mbi tokën për vitin 2021 me tendenca të ngritjës se kesaj të hyre për vitet në vijim 2022 shuma 345,956.00 si dhe për vitin 2023 rreth 377,452.00€.

Te hyrat e gjeneruara nga **regjistrimi i automjeteve** të llojeve dhe tipave të ndryshme ka dhënë rezultate të ndjeshme si rezultat i kërkesës për pagesën e tatimit në pronë para se të regjistrohet automjeti. Taksat për lejët e ndëtimit kanë ndikim të madh në strukturën e të hyrave vetanake, për vitin 2021 planifikojmë të realizohen 258,850.00€, kurse për vitin 2020 parashihen 321,415.47€ gjegjësisht 327,265.23 për vitin 2023.

Plani i të hyrave për tri vitet e ardhshme

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet metetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%);(iii) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

Tabela2: Struktura e Grandit të Përgjithshëm për 2021-2023 sipas LPPL (mil. Euro)						
Përshkrimi	**Viti 2018**	**Viti 2019**	**Viti 2020**	**Vitit 2021**	**Viti 2022**	**Viti 2023**
Të Hyrat e përgjithshme të Qeverisë	173.6	180.7	196.3	190.49	202.10	214.77
Kontigjenca për korrektim të formulës (2.7%)	4.7	4.9	-	-	-	-
Shum Fikse	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6
Popullsia (banorë)	1,780.021	1,780.021	1,780.021	1,780.021	1,780.021	1,780.021
Buxheti 89% e shumës agregate	147.1	153.3	171.5	166.30	176.60	187.90
Zona Komunale (km2)	10,901.0	10,901.0	10,901.0	10,901.0	10,901.0	10,901.0
Buxheti 6% e shumës agregate	9.9	10.3	11.6	11.21	11.91	12.67
Komuniteti pakicë në komunë	107,926.0	107,926.0	107,926.0	107,926.0	107,926.0	107,926.0
Buxheti 3% e shumës agregate	5.0	5.2	5.8	5.60	6.00	6.30
Pollusia e komunave pakicë	62,031.0	62,031.0	62,031.0	62,031.0	62,031.0	62,031.0
Buxheti 2% e shumës agregate	3.3	3.4	3.9	3.70	4.00	4.20

[8]

Në vazhdim të kësaj kornize buxhetore do të paraqesim planifikimin e të hyrave vetanake nëpër zëra të hyrave 2021, si dhe vlerësimet për vitin 2022 si dhe për vitin 2023.Gjithnjë duke respektuar të dhënat nga Qarkorja Buxhetore 2019/01.

Të hyrat vetanake janë të planifikuara me një trend të rritjes për shkak të kufirit të lart të percaktuar nga MF-ja, përsëri në bazë Qarkores 2020/01 për çdo vit fiskal. Korniza Afatmesme Buxhetore është punuar sipas vlerësimeve të kërkesave aktule të MF dhe janë të bazuar në prioritetet sektoriale të komunës për periudhën trevjeqare 2021-2023 dhe kufijtë e saj natyrisht tejkalojnë mundësitë reale të komunës por janë të bazuara në kërkesat Qarkorës nr. 2021/1 të Ministrit. Komuna do të bëjë kërkesë në MF dhe Transfereve për ta rishikuar edhe njëherë kufirin e paraparë për grumbullimin e të hyrave vetanake të komunë, (kjo po ndodh qe shumë vite përkunder kapaciteteve reale komunale për inkasim të hyrave). Duhet pritur derisa të publikohet Qarkorja e radhës për harmonizimin e kërkesave në bazë të kufijve final.

Sipas kufijve fillestar shpërndarja e grandeve dhe të hyrave vetanake komunale 2021-2023 shihet ne tablën ne vijim:

[8] KASH 2021-2023

Nr.	Përshkrimi	Kodi	VI 2021	VI 2022	VI 2023
1	2	3	11	12	13
I	Administrata dhe personeli	16323	**61,790.00**	**69,865.95**	**71,137.51**
1	Çërtifikatë lindjeje	50013	6,320.00	7,146.02	7,276.08
2	Çërtifikatë kurorëzimi	50014	7,750.00	8,762.93	8,922.41
3	Çërtifikatë vdekjeje	50015	4,350.00	4,918.55	5,008.06
4	Çërtifiaktë – vërtetime të tjera ofiqarike	50016	41,220.00	46,607.45	47,455.71
5	Taksa administrative	50019	2,150.00	2,431.01	2,475.25
II	Buxhet dhe Financa	17523	**395,840.00**	**466,285.09**	**499,970.08**
1	Tatimi në pronë	40110	314,460.00	345,956.00	377,451.00
2	Taksa për regjistrimin e automjeteve	50001	78,850.00	89,155.70	90,778.33
3	Taksa për regjistrimin e trashigimisë –	50011	-	-	-
4	Taksat për vërtetime dhe çërtifikata tjera	50019	2,530.00	2,860.67	2,912.74
5	Gjobat e biznesëve nga inspektorët	50104	-	-	-
III	Zhvillimi Ekonomik		**12,520.00**	**14,156.36**	**14,414.01**
6	Taksa komunale në biznes	50201	12,520.00	14,156.36	14,414.01
IV	Shërbimet Publike	18023	**256,000.00**	**289,459.20**	**294,727.36**
1	Taksa për leje parkingu	50008	420.00	474.89	483.54
5	Te hyrat nga koncesionimi i tregut te	50417	5,580.00	6,309.31	6,424.14
6	Te hyrat nga mbeturinat	50008	250,000.00	282,675.00	287,819.69
IV	Inspektimet		**3,850.00**	**4,353.20**	**4,432.42**
2	Gjobat nga inspektorët komunal	50104	1,250.00	1,413.38	1,439.10
4	Taksa për pranim teknik të lokaleve	50205	2,150.00	2,431.01	2,475.25
3	Gjobat mandatore - hudhja e mbeturinave	50114	450.00	508.82	518.08
V	Bujqësi dhe zhvillim rural	47023	**20,800.00**	**23,518.56**	**23,946.60**
1	Nderrimi i destinimit te tokes	50012	-	-	-
2	Taksa tjera administrative per bujqesi	50016	8,350.00	9,441.35	9,613.18
3	Shfrytezimi i prones publike	50405	-	-	-
4	Participimet në bujqësi	50409	12,450.00	14,077.22	14,333.42
VI	Gjeodezia, Kadastri dhe Prona	65115	**95,530.00**	**108,015.77**	**109,981.66**
1	Trashigimia – bartja, regjistrimi i pronës	50011	23,500.00	26,571.45	27,055.05
2	Taksë për fletë-poseduese dhe kopje plani	50012	23,200.00	26,232.24	26,709.67
3	Taksa administrative	50019	-	-	-
4	Renta - shfrytezimi i prones publike	50405	25,500.00	28,832.85	29,357.61
5	Qiraja nga objektet publike	50408	8,800.00	9,950.16	10,131.25
6	Aktivitetet në terren për matje	50504	14,530.00	16,429.07	16,728.08
VII	Urbanizmi dhe Mbrojtja e Ambientit	66620	**527,494.00**	**625,171.24**	**611,402.42**
1	Lejet ndërtimore	50009	258,850.00	321,415.47	327,265.23
2	Taksat administrative	50019	2,530.00	2,860.67	2,912.74
3	Të hyrat nga koncesioni	50417	243,614.00	275,454.35	255,320.68
4	Takse komunale per leje mjedisi	50045	22,500.00	25,440.75	25,903.77
VIII	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	73032	**43,850.00**	**49,581.20**	**50,483.57**
1	Taksa administrative DSHMS	50019	18,200.00	20,578.74	20,953.27
2	0	0	-	-	-
a	Shtëpia e shëndetit QKMF	74400	**25,650.00**	**29,002.46**	**29,530.30**
1	Participimi - arka	50409	21,500.00	24,310.05	24,752.49
2	Çërtifikatë mjeku	50409	4,150.00	4,692.41	4,777.81
3	0	0	-	-	-
b	Shërbimet Sociale - QPS	75611	-	-	-
1	Taksë administrative nga sherbimet sociale	50019	-	-	
2	0	0	-	-	
IX	Kultura, Rinia e Sporti	85023	**1,200.00**	**1,356.84**	**1,381.53**
1	Qiraja nga objektet publike	50408	350.00	395.75	402.95
2	Participimi nga KRS (biblioteka)	50409	850.00	961.10	978.59
3	0	0	-	-	-
X	Arsimi – qerdhja e fëmijëve	92115	**36,950.00**	**41,779.37**	**42,539.75**
1	Shitja e shërbimeve	50401	-	-	-
2	Qiraja nga objektet publike	50408	1,200.00	1,356.84	1,381.53
3	Participimi për kujdesin e fëmijëve	50409	35,200.00	39,800.64	40,525.01
4	Participimi për kujdesin e fëmijëve-Bajë	50409	550.00	621.89	633.20
5	0	0	-	-	
GJITHSEJ			**1,481,474.00**	**1,675,033.22**	**1,705,570.49**
Te Hyrat tjera - Gjobat nga Trafiku, Gjykata, e tjera			46,540.00	52,622.78	53,580.51
1	Të hyrar nga gjobat në trafik	50101	42,540.00	48,099.98	48,975.40
2	Të hyrar nga gjobat e gjykatave	50102	3,250.00	3,674.78	3,741.66
3	Të hyrat nga Agjensioni pyjor e tjera	50107	750.00	848.03	863.46
0			**1,528,014.00**	**1,727,656.00**	**1,759,151.00**

Buxheti 2021-2023 dhe Shpërnadarja e tij sipas kategorive ekonomike

Gjithsej Buxheti Komunal për periudhën 2021-2023

	Viti 2020	**Viti 2021**	**Viti 2022 Vlerësuar**	**Viti 2023 Vlerësuar**
Buxheti Total:	14,950,501	14,431,770.00	16,273,335.00	16,702,011.00
Numri i punëtorëve	1,373	**1,373**	**1,373**	**1,373**
Paga dhe mëditje	7,824,425.00	8,132,002.98	8,837,256.15	9,181,727.66
Mallra dhe shërbime	1,445,059.20	1,561,786.45	1,729,710.37	1,629,299.75
Shpenzime komunale	300,000.00	230,380.82	252,971.00	297,913.56
Subvencione dhe transfere	358,100.00	635,000.00	795,000.00	500,000.00
Shpenzime kapitale	4,446,448.22	3,872,599.75	4,658,397.48	5,093,070.03
Rezerva	1,107,758.00	0	0	
Burimet e financimit	14,950,501	14,431,770.00	16,273,335.00	16,702,011.00
Garantet qeveritare	13,422,487	12,903,756.00	14,545,679.00	14,933,635.00
Të hyrat vetanake	1,528,014	1,528,014	1,727,656.00	1,759,151.00

Nga Komuna e Skenderajt "Vlerësohet si shkallë e rrezikut të lartë çështja e kalkulimit të pagave me Ligjin e ri – pa instruksione dhe buxhet adekuat"

Parashikimi i shpërndarjes së mjeteve buxhetore në kategori ekonomike për vitin 2021, sipas prgrameve kryesore

		Parashikimi i ndarjës së Grandit të Arsimit në Kategorit Ekonomike sipas Qarkorës Buxhetore 2020/01
ARSIMI	*Buxheti i aprovuar*	
Viti	2020	2021
Numri i punëtorëve	905	905
Paga dhe mëditje	5,096,189.00	5,240,955.18
Mallra dhe shërbime	465,140.00	465,140.00
Shpenzime komunale	43,381.00	43,380.82
Subvencione dhe transfere	40,000.00	0.00
Shpenzime kapitale	120,000.00	70,000.00
Rezerva	658,103.00	**0**
Gjithsej:	6,810,813.00	**5,819,476.00**

QKMF	Buxheti i aprovuar	Parashikimi i ndarjës së Grandit për Shëndetësi Primare në Kategorit Ekonom. sipas Qarkorës Buxhetore 2020/01
Viti	2020	2021
Numri i punëtorëve	176	176
Paga dhe mëditje	1,182,311.00	1,267,077.00
Mallra dhe shërbime	270,000.00	246,771.50
Shpenzime komunale	49,000.00	42,000.00
Subvencione dhe transfere	70,000.00	90,000.00
Shpenzime kapitale	30,000.00	155,000.00
Rezerva	**248,056.00**	
Gjithsej:	**1,849,367.00**	**1,800,848.50**
		Parashikimi i ndarjës së Grandit për Shëndetësi Primare në Kategorit Ekonom. sipas Qarkorës Buxhetore 2020/01
ADMINISTRATA	**Buxheti i aprovuar**	
Viti	2020	2021
Numri i punëtorëve	279	279
Paga dhe mëditje	1,460,925.00	1,533,970.80
Mallra dhe shërbime	848,500.00	782,874.95
Shpenzime komunale	194,156.00	137,000.00
Subvencione dhe transfere	190,000.00	545,000.00
Shpenzime kapitale	3,603,140.00	3,627,599.75
Rezerva	201,599.00	
Gjithsej:	**6,498,320.00**	**6,626,445.50**
		Parashikimi i ndarjës së Grandit për Shërbimet Rezidenciale Ekonom. sipas Qarkorës Buxhetore 2020/01
Sherbimet Rezidenciale	**Buxheti i aprovuar**	
Viti	2020	2021
Numri i punëtorëve	13	13
Paga dhe mëditje	85,000.00	90,000.00
Mallra dhe shërbime	67,000.00	67,000.00
Shpenzime komunale	8,000.00	8,000.00
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00
Shpenzime kapitale	20,000.00	20,000.00
Rezerva	0.00	
Gjithsej:	**180,000.00**	**185,000.00**

		Parashikimi i ndarjës së Grandit të Përgjithshëm Komunal në Kategorit Ekonom. sipas Qarkorës Buxhetore 2020/01
KOMUNA		
	Buxheti i aprovuar	
Viti	2020	2021
Numri i punëtorëve	1,373	1,373
Paga dhe mëditje	7,824,425.00	8,132,002.98
Mallra dhe shërbime	1,650,640.00	1,561,786.45
Shpenzime komunale	294,537.00	230,380.82
Subvencione dhe transfere	300,000.00	635,000.00
Shpenzime kapitale	3,773,140.00	3,872,599.75
Rezerva	1,107,758.00	
Gjithsej:	**14,950,501.00**	**14,431,770.00**

Programi i investimeve publike (PIP)

Programi për Investime Publike (PIP) do të përfshijë të gjitha projektet e aprovuara sipas prioriteteve të përcaktuara me Buxhetin për vitet 2021-2023 nga ana e Kuvendit të Komunës me procedim sipas qarkores buxhetore.

Programi i investimeve publike(PIP) do të jetë pjesë e pakos së projekt-buxhetit të vitit 2021-2023 ,përmes hartimit të formularëve adekuat me arsyeshmërinë përkatëse nga secili program i organizatës sonë buxhetore. Projektet kapitale duhet të jenë në përputhje me planin kontabël, ku secili projekt gjatë hartimit të përmbaj edhe pjesën e shpenzimeve operative.

Pjesë e pandarë e kësaj kornize afatmesme buxhetore është edhe lista e projekteve kapitale për vitet 2021-2023, e cila në vazhdim do të paraqitet. Lista e projekteve për vitet fiskale 2021-2023 do të mund të modifikohet me propozime të reja në rast se do të këtë të tilla gjatë dëgjimeve buxhetore, pastaj nga ana e organeve relevante të Komunës të cilat janë përgjegjëse për hartimin e politikave zhvillimore të Komunës duke u bazuar në prioritetet e përcaktuara për financim si dhe burimin e të ardhurave, dhe kështu nga propozuesi i buxhetit në këtë rast Kryetari i Komunës do të hartojë përfundimisht projekt-Buxhetin për vitet 2021-2023, për tu proceduar si i tillë në Kuvendin e Komunës për aprovim. Në vijim lista e projekteve sipas programeve për tri vitet e ardhshme

PROJEKTE KAPITALE PËR PERIUDHËN 2021-2023

	PROJEKTET	2021	2022	2023
	URBANIZËM			
1	Mirembajtja dhe riparimi i rrugeve	110,963.35		
2	Kanalizimi fekal Qitak-Padalishtë	35,000.00		
3	Kanalizimi fekal Vitak-Qubrel	154,089.15		
4	Kanalizimi në BL Qirez	238,127.00		
5	Kanalizimi në fshatra BL Turiqevc-faza I	204,498.91		
6	Hartimi i Projekteve teknike	50,000.00	50,000.00	50,000.0
7	Kanalizmi Kllodernicë-Vitak	38,880.78		
8	Degëzimi I rrugës "17 shkurti"	50,000.00		
9	Rruget në bashkësi lokale-faza 2	150,000.00	300,000.00	350,000.0
10	Kanalizimi Vajnik-Kopiliq	70,000.00	180,000.00	
11	Kanalizimi Tushilë	80,000.00	130,000.00	
12	Kanalizimi në Bashkësi Lokale-faza 2	100,000.00	250,000.00	200,000.0
13	Kanalizimi në fshatra të BL Likovc-faza 2	160,000.00		
14	Kanalizimi në fshatra të BL Likovc-faza 3	100,000.00	350,000.00	
15	Kanalizimi Aqarevë-Tushilë-Kopiliq	70,000.00	250,000.00	
16	Rruga unaza e jashtme 1			350,000.0
17	Kanalizimi Makermal	50,000.00	150,000.00	
18	Kanalizimi fekal Kotorr-Radishevë		150,000.00	145,661.5
19	Rruga Plluzhinë-Ticë	100,000.00	180,000.00	
20	Trotuaret në rrugët lokale	153,040.56	236,848.36	300,000.0
21	Rruget me segmente në qytet	50,000.00	100,000.00	100,000.0
22	Kanalizimi fekal Izbicë-Ternovë-Leqinë		150,000.00	100,000.0
23	Kanalizimi fekal Syriganë-Banjë		100,000.00	100,000.0
24	Kanalizime me segmente në qytet	30,000.00	30,000.00	50,000.0
25	Kanalizimi në fshatra BL Turiqevc-faza II	300,000.00		
26	Kanalizimi në fshatra BL Turiqevc-faza III	70,000.00	200,000.00	
27	Unaza e brendshme 3		150,000.00	250,000.0
28	Ndertimi i poligonit multifunksional-faza III	330,000.00	150,000.00	
29	Punimi i gropave septike ne zonat e caktuara	150,000.00	200,000.00	900,000.0
	Gjithsej:	**2,844,599.75**	**3,306,848.36**	**2,895,661.5**
	SHERBIMET PUBLIKE			
1	Mirembajtja dhe riparimi i rrugeve	20,000.00	100,000.00	100,000.0
2	Projekti lled i ndriqimit në qytet	50,000.00	30,000.00	30,000.0
3	Rregullim i parqeve	20,000.00	20,000.00	50,000.0
4	Gjelbrimi i qytetit-lulet sezonale	20,000.00	15,000.00	20,000.0
5	Ndriqimi publik në Bashkësi lokale	70,000.00	100,000.00	170,000.0
6	Rehabilitimi i ujësjellësit në fshatra	50,000.00	100,000.00	100,000.0
7	Rehabilitimi i kanalizimeve nëpër fshatra	50,000.00	100,000.00	100,000.0
8	Kyqjet individuale të ujësjellësit në fshatra	80,000.00	30,000.00	100,000.0
9	Parteret në zonat urbane		50,000.00	100,000.0
10	Rregullimi i hapsirave publike në BL			100,000.0
11	Rregullimi i vorrezave të qytetit	50,000.00		
	Gjithsej:	**410,000.00**	**545,000.00**	**870,000.0**
	SHMS - QKMF-ja			
1	Renovimi i QKMF	10,000.00	25,000.00	50,000.00

2	Renovimet ne QMF dhe AMF	15,000.00	33,682.12	25,000.00
3	Vetura " Furgon " për Hemodijalizë	35,000.00	35,000.00	
4	Autoambulanca për nevoja të Emergjencës	45,000.00	111,000.00	50,000.00
5	Pajisje mjekesore për autoambulanca	10,000.00	10,000.00	15,000.00
6	Aparaturë dhe pajisje tjera mjekësore tjera per laborator		20,000.00	45,000.00
7	Automjet për kujdes shtëpiak për të moshuarit me paisje		30,000.00	
8	Rregullimi i oborrit dhe rrethojave QKMF, QMF dhe AMF		20,000.00	25,000.00
9	Blerja e aparatit të rentgenit			75,000.00
10	Automjet për kujdes shtëpiak për nëna dhe fëmijë		32,000.00	45,000.00
11	Aparaturë dhe pajisje për nevojat e Emergjencës	10,000.00	10,000.00	
12	Aparaturë dhe pajisje laboratori për QKMF,QMF		25,000.00	24,048.12
13	Veturë për nevojat e vaksinimit në teren		20,000.00	
14	Inventar dhe pajisje për nevojat e QKMF	10,000.00	10,000.00	22,000.00
15	Pajisje mjekesore për QKMF,QMF dhe AMF	10,000.00	20,000.00	50,000.00
16	Pajisje elektrike për nevojat e QKMF (sterilizator, autokllav, frigorifer)	10,000.00	20,000.00	30,000.00
17	Veture për nevojat e logjistikes			20,000.00
18	Paisje të IT-së		15,000.00	10,000.00
19	Renovimi i sistemit te ventilimit dhe oksigjenimit			20,000.00
	Gjithsej:	**155,000.00**	**436,682.12**	**506,048.1**
	ZHVILLIM EKONOMIK			
1	Krijimi i pikës informuese për Turizem	8,000.00		
2	Mirembajtja e trashegimise kulturore	10,000.00		
3	Rregullimi i shtigjeve për çiklist	12,000.00		
4	Ndertimi i infrastrukturës turistike		30,000.00	
	Gjithsej:	**30,000.00**	**30,000.00**	-
	SHERBIMET SOCIALE (QPS-ja)			
1	Rrethoja me trotoar	8,000.00		
2	Riparimi i Objektit të QPS	10,000.00		
3	Blerja e gjeneratorit	5,000.00		
	Gjithsej:	**23,000.00**		
	INSPEKTIMET			
1	Shenjat e komunikacionit	30,000.00		
	KULTURE RINI DHE SPORT			
1	Poligone sportive	70,000.00		100,000.00
	SHERBIMET REZIDENCIALE			
1	Riparimi i shtëpisë Rezidenciale	20,000.00	20,000.00	20,000.0
	ARSIMI			
1	Riparimet e shkollave	50,000.00	69,867.00	151,360.3
	Furnizim me kabinete dhe labarator shkollor	20,000.00		
	Gjithsej:	**70,000.00**	**69,867.00**	**151,360.3**
	BUXHET DHE FINANCA			
1	Bashkëfinancimi	**220,000.00**	**250,000.00**	**400,000.0**
	TOTALI:	**3,872,599.75**	**4,658,397.48**	**4,943,070.0**

Meqë me Qarkorën e parë buxhetore pranohen vetëm kufijtë indikativ të cilët mund edhe të ndërrohen, Komuna,n KAB-in e ka përgaditur sipas kërkesave fillestare të cilat edhe pritet të ndryshohen me Qarkorën e dytë të Ministris së financave.

Parashikimi i ndarjës së Grandit të Përgjithshëm Komunal , për Arsim dhe Shëndetësi Primare në kategoritë ekonomike:

	GJITHSEJ BUXHETI KOMUNAL 2021-2023			
		VITET		
	Kategoria ekonomike e shpenzimeve	**2021**	**2022**	**2023**
		Vlera në €	**Vlera në €**	**Vlera në €**
1	Pagat dhe Mëditjet	8,132,002.98	8,837,256.15	9,181,727.66
2	Mallrat dhe Shërbimet	1,561,786.45	1,729,710.37	1,629,299.75
3	Shërbimet Komunale	230,380.82	252,971.00	297,913.65
4	Subvencionet	635,000.00	795,000.00	650,000.00
5	Investimet Kapitale	3,872,599.75	4,658,397.48	4,943,070.03
	Gjithsej:	14,431,770.00	**16,273,335.00**	**16,702,011.00**

PERFORMANCA E DREJTORIVE TË KOMUNËS

1.ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Misioni

Mbikëqyrja e përgjithshme e administrimit financiar të Komunës, ekzekutimi i vendimeve të marra nga Kuvendi i Komunës, përfaqëson Komunën, nënshkruan të gjitha aktet e aprovuara nga Kuvendi Komunal, kujdeset për zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe Statutit të Komunës, bënë propozime për çështje të caktuara që janë në interes të përgjithshëm të komunës.

- **Objektivat**
  - Bënë përgatitjen e të gjitha materialeve për mbledhjet e Kuvendit Komunal;
  - Në sferën e legjislacionit të nivelit të qeverisjes lokale nxjerr Rregullore ,Vendime, Udhëzime të ndryshme etj. që kanë të bëjnë me një qeverisje sa më efikase dhe eficiente të gjitha drejtorive të komunës;

- Angazhohet për një punë me efikase të Asamblesë Komunale dhe komisioneve të saj në realizimin e punëve dhe detyrave, të cilat në të ardhmën që do të ndihmojnë në përshpejtimin e realizimit të programeve zhvillimore në nivelin komunal;
- Koordinon punët me të gjitha Drejtoritë e Komunës, anëtarët e kuvendit komunal, Komiteteve dhe Komisioneve të KK-së, me subjektet relevante në nivelin qendror dhe lokal, OJQ-të, biznesin etj, me qëllim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve ndaj qytetarit dhe për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të Komunës në përgjithësi dhe me ketë edhe të ngritjes së mërqinjës për të gjithë qytetarët e Komunës sonë;
- Koordinon dhe menaxhon burimet njerëzore brenda komunës;
- Kujdeset për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm financiar.

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

ZYRA E KRYETARIT	BUXHETI		
Kategoria Ekonomike	**2021**	**2022**	**2023**
Paga dhe mëditje	113,100.75	118,755.79	124,693.58
Mallra dhe shërbime	33,250.00	33,250.00	35,000.00
Shpenzime komunale	-	-	-
Subvencione dhe transfere	10,000.00	10,000.00	10,000.00
Shpenzime kapitale	-	-	-
TOTALI:	**156,350.75**	**162,005.79**	**169,693.58**

vitet	*2021*	*2022*	2023
Numri i të punësuarve	20	20	20

2. Kuvendit Komunal

Misioni

Kuvendi i Komunës së Skenderajt si organi më i lartë vendimmarrës në Komunë ka kompetenca të gjera konform Ligjeve, Udhëzimeve Administrative dhe Rregulloreve të RK-së ne nivel lokal. Kuvendi i Komunës aprovon buxhetin , korniza afatmesme buxhetore, rregullore komunale dhe dokumente tjera qe janë me interesa reciproke Komunë qytetar.

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

KUVENDI KOMUNAL	BUXHETI		
Kategoria Ekonomike	**2021**	**2022**	**2023**
Paga dhe mëditje	117,930.75	123,827.29	130,018.65
Mallra dhe shërbime	16,150.00	16,150.00	17,000.00
Shpenzime komunale	-	-	-
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00	0.00
Shpenzime kapitale	-	-	-
TOTALI:	**134,080.75**	**139,977.29**	**147,018.65**

Vitet	*2021*	*2022*	2023
Anëtarë të kuvendit	31	31	31

3.Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Misioni

Misioni kryesor i kësaj Zyre është që të ofrojë ndihma profesionale administrative dhe të ndihmojë në zhvillimin e gjithanshëm të gjitha komuniteteve të komunës me theks të posaçëm për minoritetet.

- Objektivat:
  - Bashkëpunimi me komunitetet rreth çështjeve që kanë të bëjnë lidhur me kërkesat e që adresohen ndaj qeverisjes lokale
  - ofrimin e kushteve sa më të favorshme për një zhvillim të gjithmbarshëm ekonomik, arsimor dhe kulturor për komunitetet dhe me ketë edhe të minoriteteve që jetojnë në komunën tonë,
  - ndihmojë në krijimin e kushteve jetësore për të kthyerit.

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

ZYRA LOKALE E KOMUNUTETEV	BUXHETI		
Kategoria Ekonomike	**2021**	**2022**	**2023**
Paga dhe mëditje	42,661.50	44,794.58	47,034.30
Mallra dhe shërbime	8,000.00	8,000.00	10,000.00
Shpenzime komunale	-	-	-
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00	0.00
Shpenzime kapitale	-	-	-
TOTALI:	**50,661.50**	**52,794.58**	**57,034.30**

vitet	*2020*	*2021*	2022
Numri i të punësuarve	8	8	8

4. Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

Misioni

Misioni i Drejtorisë për Administratë është vazhdimi i ndërtimit të një administrate moderne, profesionale , efikase , transparente dhe të besueshme në shërbim të qytetarëve dhe të komunitetit të biznesit të Republikës së Kosovës , njëkohësisht të paanshme në aspektin etnik, politik fetar, gjinor etj. që është parakusht për një administratë të qëndrueshme dhe një qeverisje lokale funksionale.

ADMINISTRAT DHE PERSONELI	BUXHETI		
Kategoria Ekonomike	**2021**	**2022**	**2023**
Paga dhe mëditje	245,894.25	258,188.93	271,098.41
Mallra dhe shërbime	180,500.00	180,500.00	190,000.00
Shpenzime komunale	-	-	-
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00	0.00
Shpenzime kapitale	-	-	-
TOTALI:	**426,394.25**	**438,688.93**	**461,098.41**

vitet	*2021*	*2022*	2023
Numri i të punësuarve	50	50	50

Me qëllim të identifikimit të shpenzimeve për çështje të bazazisë gjinore dhe organizimin e aktiviteteve të cilat e promovojnë avansimin e gruas ne shoqëri qe nga viti 2020 komuna ka planafikuar nënkodin e veqant për çeshtje.

QESHTJET GJINORE	BUXHETI		
Kategoria Ekonomike	**2021**	**2022**	**2023**
Paga dhe mëditje	29,247.75	30,710.14	32,245.64
Mallra dhe shërbime	9,500.00	9,500.00	10,000.00
Shpenzime komunale	-	-	-
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00	0.00
Shpenzime kapitale	-	-	-
TOTALI:	**38,747.75**	**40,210.14**	**42,245.64**

vitet	*2021*	*2022*	2023
Numri i të punësuarve	4	4	4

OBJEKTIVAT

- Arritja e standardeve dhe nivelit të vendeve të zhvilluara në ofrimin e shërbimeve për qytetarë ,
- Transformimi ,standardizimi dhe funksionalizimi i sa më shumë shërbimeve elektronike ,
- Integrimi i sa më shumë programeve elektronike në lehtësim të shërbimeve për qytetarë
- Avancimi i e-qeverisjes në koordinim dhe kontinuitet me MAPL-në dhe ASHI-në etj.
-

- Objektivat e Performancës

Matjet kryesore të performancës	*2021*	*2022*	*2023*
Transformimi i shërbimeve nga ato fizike në elektronike	96%	97%	98%
Ulja e kohës së pritjes për qytetarë	6'	5'	3'
Ulja e kohës së kryerjes së shërbimit	3'	2'	2'
Kontroll i shërbimeve dhe raport i shpejtë dhe i saktë	96%	97%	98%

5. Drejtoria për Buxhet e Financa

Misioni

Misioni i Drejtorisë për Buxhet e Financa është sigurimi i menaxhimit të përgjegjshëm, të drejtë dhe transparent të fondeve publike, krijimi i politikave fiskale të favorshme për nxitjen e investimeve të huaja dhe vendore me qëllim të zhvillimit ekonomik lokal krijimi i një buxheti që rritë efikasitetin dhe efektivitetin e tij për alokimin e drejtë dhe me prioritet të resurseve në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë komunale.

Drejtoria funksionon përmes këtyre sektorëve :

1. Sektori për buxhet financa
2. Sektori i të hyrave
3. Sektori i tatimit në pronë dhe

Punën e vet drejtoria do të orientojë në :

a. Hartimin e draft buxhetit për vitin në vijim
b. Krijimin e një KAB-i të përgjegjshëm
c. Përgatitjen e pasqyrave financiare
d. Përgatitja e raporteve të rregullta sipas LMFPP
e. Raportimin e rregullt në KPF, Kuvend dhe MF
f. Krijimin e politika të favorshme fiskale
g. Zbatimin e buxhetit të aprovuar
h. Rritjen e efikasitetit ,efektivitetit dhe transparencës për shpenzimin e parasë publike
i. Krijimin e kushteve të favorshme për bizneset
j. Kujdesin ndaj pasurisë
k. Mbështetje komunitetit të biznesit

Objektivat e drejtorisë:

1. Ruajtja e stabilitetit buxhetor përmes politikave të kontrollit të brendshëm
2. Ruajtja e trendit të arkëtimit të hyrave vetanake, dhe rritja e burimeve të tyre,
3. Prioriteti i investimeve të taksa - paguesit me më shumë pjesëmarrje në të hyra vetanake të Komunës (tatimi në pronë)

Arritja e objektivave të lartë përmendura kërkon edhe politikat e veta të zbatimit drejt arritjes se rezultateve. Dy burime të qëndrueshme që ndikojnë në realizimin e objektivave të Drejtorisë janë të hyrat vetanake nga burimet e rregullta të taksave për regjistrimin e automjetev dhe Tatimi në Pronë.

a) Taksa për regjistrimin e automjeteve janë te rregulluara sipas Rregullores komunale për taksa , Tarifa dhe Ngarkesa

b) Tatimi në Pronë, i vetmi tatim që arkëton Komuna është një prej burimeve kryesore të, të hyrave vetanake. Kjo e hyrë i kthehet qytetarit në mënyrë indirekte në projekte. Të hyrat nga Tatimi në Pronë rrjedhin nga pasuria individuale e qytetarëve. Numri i tyre është 11611, me një mesatare prej 25.5 € euro në vit për një obligues.
Synimet e Drejtorisë janë që gjatë tri viteve të ardhme të përfshihen të gjitha pronat e pa regjistruara për qëllime të Tatimit në Pronë dhe ndryshimet eventuale në pasuritë e regjistruara. Numri i tyre pritet të jetë 12.900, qe do te shënoj rritjen e te hyrave vetanake per tri vite ne vijim.(tabela e te hyrave vetanake faqe 19)

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

BUXHET DHE FINANCA	BUXHETI		
Kategoria Ekonomike	**2021**	**2022**	**2023**
Paga dhe mëditje	145,650.75	152,933.29	160,579.95
Mallra dhe shërbime	27,075.00	27,075.00	28,500.00
Shpenzime komunale	-	-	-
Subvencione dhe transfere	0.00	-	-
Shpenzime kapitale	220,000.00	250,000.00	400,000.00
TOTALI:	**392,725.75**	**430,008.29**	**589,079.95**

vitet	*2021*	*2022*	2023
Numri i të punësuarve	29	29	29

- Objektivat e Performancës

Matjet Kryesore të Përformancës	*2021*	*2022*	*2023*
Përgatitja e draft buxhetit për vitin në vijim	1	1	1
Përgatitja e KAB-it	1	1	1
Përgatitja e Qarkoreve Buxhetor	2	2	
Rrjedha e parasë së gatshme	2	2	2
Raportimet e rregullta tremujore	4	4	4
Rishikimi i buxhetit aktual	1	1	1
Pasqyrat financiare vjetore	1	1	1
Ridestinimi i mjeteve	1	1	1
Shkresa të ndryshme për Ministritë e RK (dezotimi ....)	20	25	30
Barazimet mujore me MF	12	12	12
Alo kimet mujore e të hyrave vetjake komunale	12	12	12
Menaxhimi i shpenzimit të fondeve ne dispozicion	2021	2022	**2023**
Zotimi mjeteve buxhetore	1100	1200	1250
Shpenzimi i mjeteve buxhetore	4500	4900	5200
Certifikimi	4500	4900	5200
Azhurnimi i mjeteve themelore-aseteve komunale	2	2	2
Regjistrimi pronave të reja – tatimi në pronë	500	700	800

6. Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë

Misioni

Misioni i DGJKP – së është bashkëpunimi dhe krijimi i marrëdhënieve të ngushta me Agjencinë Kadastrave të Kosovës, Ministritë e linjës, Agjencitë e linjës si dhe institucionet tjera në nivel lokal dhe qendror të Republikës së Kosovës në fushën e gjeodezisë, kadastrat dhe pronësisë me qëllim të krijimit të kushteve për modernizimin e të dhënave nga këto fusha, mirëmbajtjen e regjistrave kadastral dhe ofrimin e shërbimeve sa më efikase, të shpejta dhe cilësore duke u mbështetur gjithnjë në legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë. Ngritja e cilësisë së shërbimeve përmes aftësimit të burimeve njerëzore me programet e reja të cilat do të aplikohen në fushën e gjeodezisë, kadastrit dhe pronësisë.

Objektivat :

a. Respektimi i afateve ligjore në trajtimin e kërkesave dhe nxjerrja e vendimeve në përputhje me ligjet dhe afatet e parapara ligjore në fuqi ndaj këtyre kërkesave;
b. Funksionalizimi dhe integrimi i sistemit të SIKTK me Gjeodezinë;
c. Identifikimi i sistemit të adresave dhe regjistrimi i adresave;
d. Mirëmbajtja e evidencës së patundshmërive;
e. Ofrimi i shërbimeve cilësore, efikase dhe të shpejta duke respektuar legjislacionin në fuqi;
f. Implementimi i programeve elektronike të avancuara të cilat kanë mbështetje në ligjet e aplikueshme dhe të ofruara nga AKK.

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

KADASTER DHE GJEODEZI	BUXHETI		
Kategoria Ekonomike	**2021**	**2022**	**2023**
Paga dhe mëditje	85,923.60	90,219.78	94,730.77
Mallra dhe shërbime	13,000.00	13,000.00	15,000.00
Shpenzime komunale	-	-	-
Subvencione dhe transfere	0.00	-	-
Shpenzime kapitale	-	-	-
TOTALI:	**98,923.60**	**103,219.78**	**109,730.77**

Vitet	*2021*	*2022*	2023
Numri i të punësuarve	19	19	19

Matjet kryesore të përformancës	*Planifikimi 2021*	*Planifikimi 2022*	*Planifikimi 2023*

	Sektori për Gjeodezi			
1	Kopje Plani	700	750	840
	Ndarje fizike	90	95	98
	Sektori për Kadastër			
	Certifikatë pronësie	9200	9400	9700
2	Regjistrim i pronës	400	410	420
	Regjistrim i hipotekave	51	54	57
	Informata periodike të ndryshme	12	12	12
	Sektori për Pronësi			
	Ndarja e pronës publike	5	12	20
	Vërtetim pronësie	110	122	135
3	Konkluzione për ndërprerje procedure	Sipas nevoje	Sipas nevoje	Sipas nevoje
	Rregullimi i statusit të pronës	Sipas nevoje	Sipas nevoje	Sipas nevoje

7. Drejtoria për Planifikim Urbanë dhe Mbrojtje të Mjedisit

Misioni

Misioni i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit është planifikimi Urban ,zhvillimi dhe menaxhimi i projekteve kapitale si dhe zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve në mbrojtjen e mjedisit.

Orientimi i punës së Drejtorisë është :

1.Planifikimi Urban

- Hartimi i planeve rregulluese
- Hartimi i mikrolokacioneve dhe makrolokacioneve
- Hartimi i projekt propozimeve për projektet kapitale
- Hartimi i projekteve te detajuara per realizimin e këtyre projekteve si në projektet e infrastrukturës rrugore ,rrjetit të ujësjellësve dhe kanalizimeve rregullimin e trotuareve shesheve dhe zonave gjelbëruese ,ne rregullimin e shtretërve te lumenjve ,terreneve sportive etj.
- Hartimin e projekteve të ndërtimit të lartë si : Institucionet shkollore ,shëndetësore ,sportive ,të banimit ,afarizmit objekte fetare etj.

2.**Implementimi i Projekteve Kapitale**:

- Të gjitha projektet e hartuara të cekura më lartë Drejtoria me stafin e vet bënë mbikëqyrjen në implementimin dhe realizimin e këtyre projekteve .
- Me stafin e Drejtorisë bënë pranimet teknike të projekteve të përfunduara
- Bënë implementimin e Planeve Rregulluese
- Lëshon Lejet e ndërtimit
- Me rastin e Lëshimit të Lejeve të Ndërtimit inkason edhe të hyrat financiare të vjelura përmes taksës administrative të Lejes ndërtimore dhe taksës në infrastrukturë.

3.**Mbrojtja e Ambientit**

- Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjes së Ambientit angazhohet që të implementimin ligjet dhe rregulloret e hartuara prej Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rregullores Komunale për Taksa, tarifa dhe Ngarkesa dhe rregulloret Komunale në Mbrojtjen e Mjedisit

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	BUXHETI		
Kategoria Ekonomike	**2021**	**2022**	**2023**
Paga dhe mëditje	61,544.70	64,621.94	67,853.02
Mallra dhe shërbime	12,000.00	12,000.00	15,000.00
Shpenzime komunale	-	-	-
Subvencione dhe transfere	-	-	-
Shpenzime kapitale	2,844,599.75	3,306,848.36	2,895,661.52
TOTALI:	**2,918,144.45**	**3,383,470.30**	**2,978,514.54**

Vitet	*2021*	*2022*	2023
Numri i të punësuarve	15	15	15

8. Drejtoria për Shërbime Publike

Misioni

Misioni i Drejtorisë për Shërbime Publike është ofrimi i shërbimeve të qytetarëve në mirëmbajtjen e rrjetit të Ujësjellësit dhe kanalizimit, mirëmbajtja e hapësirave publike (Shesheve dhe Parqeve), ofrimin e shërbimeve në transportin Publik, Urban dhe Rural, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, monitorimin mbi menaxhimin dhe trajtimin e mbeturinave, mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve dhe hapësirave tjera publike, rregullimin e sigurisë në komunikacion (sinjalizimi i rrugëve) dhe ofrimin e ndihmës qytetarëve në rastet e Emergjencave, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi tjera.

Drejtoria e Shërbimeve Publike funksionon përmes këtyre sektorëve:

1. Sektori Për Shërbime Publike dhe
2. Sektori Për Mbrojtje dhe Shpëtim

Bazuar në sektorët e ndarë në dy fusha ashtu do të organizohen edhe punët dhe detyrat e secilit sektor për të realizuar misionin, për të arritur synimet tona si Drejtori.

Vizioni i Drejtorisë është ngritja e cilësisë në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në fushat të cilat i ka të përcaktuara në misionin sajë.

Objektivat e drejtorisë:

a. Përmirësimi i cilësisë për shërbim me ujë të pijshëm
b. Monitorimi i trajtimit të ujërave të zeza
c. Mirëmbajtja dhe rregullimi i hapësirave publike (shesheve dhe parqeve)
d. Rregullimi i transportit publik në të gjitha vendbanimet
e. Mirëmbajtjen e ndriçimit publik
f. Grumbullimin, transportimin dhe deponimin e të gjitha llojeve të mbeturinave
g. Largimi i borës nga rrugët, hapja dhe zhbllokimi i rrugëve gjatë sezonit dimëror
h. Larja dhe pastrimi i rrugëve dhe shesheve gjatë sezonit veror
i. Sinjalizimi i rrugëve në qytet dhe rrugëve në zonat rurale
j. Ngritja e nivelit të gatishmërisë në intervenimet për raste emergjente dhe fatkeqësitë natyrore

Drejtoria përmes këtyre objektivave do të synojë arritjen e qëllimeve si dhe koordinimin dhe organizimin e punëve mes dy sektorëve dhe Policinë.

Qëllimi i Drejtorisë është ngritja e nivelit të shërbimeve efikase dhe cilësore ndaj qytetarëve si dhe përmirësimin e kushteve sociale për qytetarët në sektorët ku drejtoria ofronë shërbimet. Prandaj, për të arritur qëllimet tona patjetër na duhet shtrirja e një serë aktivitetesh, ku për t'i

zhvilluar këto aktivitete krijohen dhe implikime buxhetore si në shpenzimet e stafit për paga dhe mëditje po ashtu edhe ne mallra dhe shërbime, komunali dhe kapitale.

Politika e re : Për të arritur këtë synim duhet edhe shtimi i stafit të domosdoshëm për këtë qëllim: **Zyrtarin për efiqencë të energjisë**. Ku për këtë pozicion kërkohet përgatitje superiore me koeficient 7 dhe sipas kësaj do të paraqiten implikime shtesë, pra do të kemi rritje si në pagë dhe mëditje po ashtu edhe në mallra dhe shërbime. Buxheti i përgjithshëm për këtë pozicion – 7,000.00

Në tabelën e më poshtme kemi paraqitur të gjitha shpenzimet e mundshme në të gjitha kategoritë si:

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

SHERBIMET PUBLIKE	BUXHETI		
Kategoria Ekonomike	**2021**	**2022**	**2023**
Paga dhe mëditje	217,466.55	228,339.88	239,756.87
Mallra dhe shërbime	361,000.00	361,000.00	380,000.00
Shpenzime komunale	130,000.00	130,000.00	169,832.74
Subvencione dhe transfere	75,000.00	75,000.00	10,000.00
Shpenzime kapitale	410,000.00	545,000.00	870,000.00
TOTALI:	**1,193,466.55**	**1,339,339.88**	**1,669,589.61**

vitet	*2021*	*2022*	2023
Numri i të punësuarve	35	35	35

- Objektivat e Performancës

Matjet kryesore të përformancës	*2021*	*2022*	***2023***
Marrja e mostrave të ujit (analizat)	24	26	28
Trajtimi i ujërave të zeza në Impiant	95%	97%	98%
Mbjellja e luleve dhe drunjtëve dekorues	13000	15500	16000
Regjistrimi i vijave të transportit Publik	95%	100%	100%
Blerja e Kontejnerëve për mbeturina 120 litra	1000	2500	3000
Blerja e kontejnerëve për mbeturina 1m3	1000	1000	1000
Grumbullimi, eliminimi dhe deponimi i mbeturinave	70%	85%	90%
Largimi i borës nga rrugët dhe hapësirat publike	95%	97%	98%
Larja dhe fshirja e rrugëve dhe shesheve	90%	96%	98%
Vendosja e shenjave vertikale dhe horizontale	90%	95%	98%
Intervenimet në shuarjen e zjarreve	100%	100%	100%
Pastrimi i objekteve komunale	100%	100%	100%
Sigurimi i objekteve komunale	100%	100%	100%

9. DREJTORISË PËR BPZHR

Misioni

" Të jetë lider në promovimin e zhvillimit ekonomik rural të Komunës së Skenderajt"

Deklarata e misionit- Implementon politikat zhvillimore në bujqësi, koordinon dhe mbikëqyrë projektet bujqësore, asociacionet bujqësore, përgatitë projekte për zhvillim rural ,përgatitë planin vjetor për të mbjellurat vjetore dhe siguron që këto plane të implementohen.

Objektivat:

a) Trajnimi dhe edukimi i fermerëve të cilët jetojnë në pjesën rurale të komunës
b) Udhëzon dhe ndihmon fermerët për punimin e projekteve për aplikim në fondet e donatorëve të mundshëm
c) Përkrahja financiare projekteve nga MBPZHR së me bashkëfinancim me fermerët
d) Subvencionimi i fermerëve në sektorët e ndryshëm të bujqësisë
e) Organizon panaire të ndryshme dhe promovon vlerat e fermerëve

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

BUJQESIA DHE PYLLTARI DHE ZHR	BUXHETI		
Kategoria Ekonomike	**2021**	**2022**	**2023**
Paga dhe mëditje	78,978.90	82,927.85	87,074.24
Mallra dhe shërbime	15,000.00	15,000.00	20,000.00
Shpenzime komunale	-	-	-
Subvencione dhe transfere	150,000.00	150,000.00	150,000.00
Shpenzime kapitale	-	-	-
TOTALI:	**243,978.90**	**247,927.85**	**257,074.24**

vitet	*2021*	*2022*	2023
Numri i të punësuarve	20	20	20

Fermerët e komunës do të trajtohen përmes Ministrisë së Bujqësisë dhe ZHR në mbjellën e grurit, misrit, subvencionimi i mbajtjes së lopëve , deleve shtimin e numrit të shoqërive të bletëve si dhe sigurimin e grandeve për mekanizëm të nevojshëm bujqësor. Gjithashtu drejtoria planifikon të vazhdojë të organizojë panairin e dredhëzës, mjaltit etj.

- Objektivat e Performancës

Matjet Kryesore të Përformancës	*2021*	*2022*	*2022*
Trajtimi i farmerëve nga Fondi për zhvillin e bujqësisë	2100	2300	2600
Kërkesat e vlerësuara të farmerëve për aplikim ne FZHB	2100	2300	2600
Organizimi panaireve	3	4	5
Subvencionimi i bujqëve nga fondi komunal për Subvencione	250	300	350
Bashkpunimi me donatorë dhe organizata	5	6	8
Mbrojtja dhe ruajtja e pyejeve			
Identifikimi i pronave të punueshme bujqësore	14000	16000	17000

10. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Misioni

Misioni i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) zhvillimi i aktiviteteve kulturore-sportive dhe angazhimi i rinisë në këto aktivitete, shenimin e datave historike dhe kremtimin e tyre. Organizon festivale, koncerte festive dhe humanitare , Gjithashtu, DKRS organizon mbajtjen e tubimeve përkujtimore, promovimin e librave, promovimin e kreativitetit në arte muze, arkivi dhe trashëgemisë kulturore dhe shumë aktiviteteve tjera që zhvillohen në kuadër të komunës.

Drejtoria funksionon përmes këtyre sektorëve:

1. Sektori i Kulturës
2. Sektori i Rinisë
3. Sektori i Sportit dhe
4. Sektori i Bibliotekës

Prioritetet:

- Avancimi i jetës kulturore, rinore dhe sportive.
- Përmirësimi i infrastrukturës kulturore dhe sportive.
- Përkrahja e aktiviteteve të organizatave rinore joqeveritare dhe krijimi i hapësirave vepruese.
- Organizimi i garave të ndryshme sportive;

- Menaxhimi i hapësirave publike kulturore dhe sportive;
- Kujdesi për trashëgiminë kulturore, arkiv dhe muzeun komunal
- Subvencionimin e të gjitha klubeve publike në sportet përkatëse

Punën e vet Drejtoria do ta orientojë në:

a) Udhëheqjen në mënyrë të drejtë me teatër, bibliotekë, arkiv, muze, stadiumin e qytetit, palestrën e sporteve në përputhshmëri me ligjet dhe aktet normative në fuqi
b) Kujdesin për formacione të tjera nga Kultura, Rinia, e Sporti që nuk kanë hapësirë e kushte pune;
c) Organizmin dhe shënimin e datave me rëndësi historike kur kërkohet;
d) Organizimin e debateve për zhvillim dhe avancim të kulturës dhe trashëgimisë kulturore
e) Gjetjen e mundësive për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
f) Grumbullimin e shënimeve faktike për të arriturat në Kulturë, Rini, Sport e Bibliotekë
g. Bshkëpunim të ngushtë dhe raportimi për punën e vet Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal, Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini, Fe dhe Sport kurdo që kërkohet;
h. Bashkëpunim me Drejtoritë komunale dhe në nivel qendror nga fushë veprimtaria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të këmbejë përvoja, si dhe me OJQ-të e organizata tjera; Bashkpunim me MKRS, KOK , Federatat sportive dhe federaten e sportit shkollor, dhe Federatat vendore dhe ndërkombëtare sportive
i. Respektimin dhe përkrahjen e asociacioneve, klubeve, shoqatave dhe krijimin e individë me aftësi të posaçme kreative pa bërë ndonjë dallim, racor, gjinor apo fetar;
j. Ofrimin e institucioneve të veta në shërbim të përgjithshëm të qytetarëve (me veprimtaritë primare që kryejnë ato, por në raste emergjente dhe veprimtari të tjera);
k. Joshjen e investitorëve, kërkimin e fondeve shtesë;
l. Organizimin e debateve për avancim dhe zhvillim të sportit;
m. Organizimin e anketave, seminareve e trajnimeve për kyçje të rinjve në aktualitetet rinore, evropiane e botërore;
n. Regjistrimin e grupeve, klubeve, kuvendeve etj.
o.

Për të realizuar misionin e vet, Drejtoria planifikon të realizojë këto objektiva:

- Ruajtja e stabilitetit buxhetor përmes politikave të kontrollit të brendshëm.

- Shfrytëzimi racional i hapësirave kulturore dhe sportive duke krijuar kushte të barabarta për të gjithë.
- Rritja e përkrahjes për grupet dhe individët që tregojnë sukses në fushën e artit, kulturës dhe sportit.
- Rritja e kujdesit për trashëgiminë kulturore

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

KULTUR RINE E SPORT	BUXHETI		
Kategoria Ekonomike	**2021**	**2022**	**2023**
Paga dhe mëditje	102,492.60	107,617.23	112,998.09
Mallra dhe shërbime	15,000.00	15,000.00	19,000.00
Shpenzime komunale			-
Subvencione dhe transfere	120,000.00	120,000.00	125,000.00
Shpenzime kapitale	70,000.00		100,000.00
TOTALI:	**307,492.60**	**242,617.23**	**356,998.09**

Vitet	*2021*	*2022*	**2023**
Numri i të punësuarve	22	22	22

Objektivat e përformancës

Nr	*Përmbajtja e aktivitetit*	*Sektori*	*Afati*
1.	Dita e Pavarësisë së Kosovës. .	K.R.S	17 Shkurt
2.	Beteja e Likoshanit dhe Çirezit. Akademi dhe aktivitete tj.	Kulturë	28 Shkurt
3.	Java kulturo-sportive "Epopeja e UÇK-së	K.R.S	1-7 Mars
4.	Turniri Memorial "Ilir Lushtaku" në futboll të vogël	Sport	26 Mars
5.	28 Mars- Dita e përkujtimit të Martirëve të Skenderajt	K.R.S	26,27 dhe 28 Mars
6.	Liga komunale ne futboll te vogel	Sport	Gjatë tërë vitit
7.	Turniri memorial në futboll të vogël "Ilaz Kodra"	Sport	Prill
8.	Aktivitet për maturantët	Rini	Maj
9.	Java e dhurimit të librit	Kulturë, biblioteka	Maj
10.	Festivali i Teatrove shkollore dhe për fëmijë	Kulturë	3,4,5 Qershor
11.	Kolonia e Artistëve të artit figurativ	Kulturë, Rini	15,16,17 qershor
12.	Dita e Çlirimit të Skenderajt	K.R.S	18 Qershor
13.	Java e Diasporës	K.R.S	Korrik
14.	Muaji rinor	K.R.S	Shtator
15.	Aktivitete rinore për shënimin e datave ndërkombëtare	Rini	Gjatë gjithë vitit
16.	Mbështetja e Qendrës Rinore Publike	Rini	Gjatë gjithë vitit
17.	28 Nëntori & Fest. Folk "Rapsodia Shqiptare"	K.R.S	26,27 dhe 28
18	Mbështetja financiare për Ansamblin ''Drenica"	Kulturë	Mars – Qershor
18.	Aktivitetet Kulturore (Muzeu, Arkivi dhe Teatri).	Kulturë	Gjatë vitit

19.	Përzgjedhja e më të mirëve në fushën e kulturës dhe sportit	K.R.S	Dhjetor
20.	Aktivitete tjera kulturore: Promovime librash, ekspozita, etj.	Kult.Biblio.	Gjatë tërë vitit
21.	Pritja e Vitit të Ri	Rini	Dhjetor
22.	Organizimi i debateve dhe tryezave të ndryshme me të rinjtë	Rini	Gjatë gjithë vitit
23.	Mbështetja e klubeve sportive	Sport	Gjatë gjithë vitit

11. DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK NDËRMARRËSI INOVACION DHE TURIZËM

Misioni

Të Përmirësojë ambientin për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Të implementojë strategjitë për Zhvillimin Ekonomik Lokal (aktualisht planin 2019-2023). Drejtoria synon të themelojë "partneritet" me komunitetin e bizneseve dhe e sheh rolin e saj si promovues të përmirësimit të infrastrukturës si bazë për zhvillim ekonomik. Drejtoria, gjithashtu ka për qëllim thjeshtësimin e rregulloreve dhe procedurave komunale që kanë të bëjnë me veprimtarin e bizneseve në Komunë

Zyra e zhvillimit ekonomik:

Deklarata e misionit: Zyra e Zhvillimit Ekonomik përqendrohet në përmirësimin e ekonomisë në Skenderaj përmes: 1) ruajtjen dhe rritjen e bizneseve që aktualisht operojnë/veprojnë në Skenderaj, 2) inkurajimi i fillimit të bizneseve nga banorët e Komunes , inkurajimi i bizneseve të reja të vendosen në Skenderaj

Zyra për planifikim

Deklarata e misionit; Zyra për planifikim punon me zyrat tjera komunale për të bërë planifikimin për projektet dhe për identifikimin e nevojave në infrastrukturë në fshatra dhe qytet. Sektori për planifikim mirëmban një listë për projektet prioritare, në baza dy-vjeqare

Administrata

Deklarata e misionit: Administrata siguron drejtime dhe koordinon me zyrat tjera komunale dhe me bizneset private. Administrata bënë planifikimin dhe mbikëqyrë punën e bërë nën planin e Zhvillimit Ekonomik Lokal.

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

ZHVILLIM EKONOMIK	BUXHETI		
Kategoria Ekonomike	**2021**	**2022**	**2023**
Paga dhe mëditje	30,939.30	32,486.27	34,110.58
Mallra dhe shërbime	11,000.00	110,000.00	15,000.00
Shpenzime komunale			-
Subvencione dhe transfere	70,000.00	70,000.00	35,000.00
Shpenzime kapitale	30,000.00	30,000.00	-
TOTALI:	**141,939.30**	**242,486.27**	**84,110.58**

Vitet:	*2021*	*2022*	*2023*
Burimet e pozitave	10	10	10

Matjet kryesore të performances

Programi: burimet financiare	2021	2022	2023
Administrata	2500	3000	3500
Zyra për zhvilllim e komunikim			
Regjistrimin e biznseve të reja	180	190	200
Trajnime për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të hapin biznes	20	30	30
Mbajtja e panaireve	2	2	2
Mbajtja e garës për ide inovative	1	1	1
Zyra për planifikim ekonomik			
Ndarja e granteve për Start-up	50.000	60.000	70.000
Participimi tek NVM që dëshirojnë me hap dege të re prodhuese	45.000	50000	60.000
Krijimi i Qendrës për trajnime	1		
Krijimi i infrastrukturës së nevojhme për zhvilim e konomik			
Sinjalizimi i pikave turisike	1		

12. DREJTORIA PËR ARSIM

Misioni

Misioni i Drejtorisë për Arsim është ngritja e cilësisë, menaxhimi dhe koordinimi i arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm si dhe përgjegjësia dhe transparenca në punë.

Drejtoria Komunale e Arsimit funksionon sipas këtyre sektorëve:

1.Sektori i administratës

2.Sektori për buxhet dhe financa

3.Sektori i Arsimit i ndarë sipas niveleve:

-niveli parashkollor dhe fillor(0-1)

-niveli i mesëm i ulët (2)

-niveli i mesëm i lartë (3)

4.Sektori i shërbimeve teknike

Punën e vet drejtoria do ta orientojë :

- në menaxhimin dhe drejtimin efikas të punëve brenda drejtorisë,
- rexhistrimin dhe përfshirjen e të gjithë nxënësve në bankat shkollore,
- krijimin e kushteve të favorshme për punë në të gjitha institucionet shkollore,
- menaxhimi dhe koordinimi i arsimit parashkollor,fillor dhe të mesëm në komunë,
- pajisja e shkollave më mjete të nevojshme didaktike ,
- përfshirja në aftësimin profesional të mësimdhënësve, stafit profesional dhe drejtorëve të shkollave,
- ngritja e infrastrukturës shkollore - ndërtimit të objekteve të reja shkollore në këtë vit shkollor ndërtimi i dy objekteve shkollore investim i ministrisë së arsimit,
- renovimet dhe përgatitjet higjeno-teknike të shkollave,
- planifikimi dhe sigurimi i bursave për studentet e komunës brenda mundësive buxhetore.
- planifikimi dhe sigurimi i bursave brenda mundësive buxhetore për nxënësit më gjendje të rëndë ekonomike .

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

ARSIMI	BUXHETI		
Kategoria Ekonomike	**2021**	**2022**	**2023**
Paga dhe mëditje	5,300,957.43	5,662,588.36	6,544,423.66
Mallra dhe shërbime	478,140.00	497,335.37	385,629.75
Shpenzime komunale	43,381.82	40,971.00	43,380.82
Subvencione dhe transfere	70,000.00	120,000.00	40,000.00
Shpenzime kapitale	70,000.00	69,867.00	151,360.39
TOTALI:	**5,962,479.25**	**6,390,761.73**	**7,164,794.62**

vitet	*2021*	*2022*	2023
Numri i të punësuarve	915	915	915

Matjet Kryesore të Performancës	*2021*	*2022*	***2023***
Vizita në shkolla	400	400	400
Organizimi i Testit Shtetëror të Maturës	2	2	2
Organizimi i Testit të Arritshmërisë	1	1	1
Vlerësimet e brendshme	100	100	100
Organizimi i garave në nivel shkolle, komune, rajoni dhe republike	45	45	45
Mbajtja dhe organizimi i Ditëve të Shkollave	27	27	27
Vizita dhe kontrolla të administratës së shkollave	100	100	100
Vizita për renovime dhe mbikëqyrje të shkollave	130	130	130
Regjistrimi i inventarit në shkolla	1	1	1
Shpallja e konkurseve të rregullta dhe të jashtëzakonshme	6	6	6
Rrjedha e parasë	1	1	1
Deklarimi i faturave të papaguara	12	12	12
Zotimi i mjeteve buxhetore	12	12	12
Shpenzimi i mjeteve buxhetore	12	12	12
Takimet e rregullta me drejtorë shkollash, me zyrtarë të rajonit dhe të MASHT	12+6+12	12+6+12	12+6+12
Aktivitete sportive, kulturore	9	9	9
Aktivitete profesionale	3	3	3

13. DREJTORISË PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENJE SOCIALE

Misioni

DSHMS-ja ka për mision të vetin të sigurojë, përforecojë dhe ofrojë qasje në shërbime cilësore të kujdesit primar shëndetësor, staf mjekësor të shkathët dhe programe inovative si dhe të zhvillojë sistemin e ofrimit të mbrojtjes parësore shëndetësore sa më cilësore, duke u bazuar në nevojat e popullatës në tërë territorin e komunës si dhe përkujdesjen sociale për të gjithë banorët, veçmas të atyre me status të rëndë social, në kuadër të mundësive të saja . Funksionin e sajë e kryen përmes Kujdesit Primar Shëndetësor QKMF, Qendrës për Pune Sociale QPS, Shtëpisë së Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare SHPMPF dhe Administratës. Stafi i përgjithshëm 216.

Objektivat e drejtorisë

- Përmirësimi i menaxhimit në drejtim të caktimit të qartë të prioriteteve në lidhje me kujdesin shëndetësor si dhe involvimin e partnerëve në çështjet ku është e nevojshme një çasje gjithëpërfshirëse;
- Vendosja e një agjende të saktë në lidhje me aktivitetet, çasje stimulative në aplikimin e njohurive ekzistuese si dhe ofrimin e mundësisë për zgjerim të njohurive dhe shkathtësive për stafin, përmes zhvillimit të vazhdueshem profesional;
- Vendosja e normave dhe standardeve si dhe promovimi dhe monitorimi i implemetimit të tyre duke pas parasysh mjekësinë e bazuar në të dhëna bashkëkohore dhe artikulimin e çështjeve që kanë të bejnë me etikën profesionale;
- Ofrimi i mbështetjës teknike, inicimin e ndryshimeve dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale të qëndrueshëm;
- Monitorimi i gjendjes shëndetësore si dhe vlerësimin e trendëve shëndetësore në komunë.
- Përkrahja e aktiviteteve sociale përmes involvimit më të madh të QPS dhe SHPMPF (Shtëpisë se Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare) dhe partnerëve tjerë qeveritar dhe joqeveritar në rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale në komunë;
- Tani edhe me funksionalizimin e objektit të ri të QKMF-së do të ofrojmë një standardizim të infrastruktures moderne në kuadër te shërbimeve shëndetësore, ku do të mundësojmë efikasitet dhe sherbime më të shpejta më cilësorë dhe më bashkohore për qytetarët.

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

ADMINISTRAT E SHENDETESISE	BUXHETI		
Kategoria Ekonomike	**2021**	**2022**	**2023**
Paga dhe mëditje	46,773.30	49,111.97	51,567.56
Mallra dhe shërbime	13,000.00	13,000.00	16,500.00
Shpenzime komunale	-	-	-
Subvencione dhe transfere	50,000.00	50,000.00	10,000.00
Shpenzime kapitale	-	-	-
TOTALI:	**109,773.30**	**112,111.97**	**78,067.56**

SHERBIMET SOCIALE	BUXHETI		
Kategoria Ekonomike	**2021**	**2022**	**2023**
Paga dhe mëditje	100,512.30	105,527.92	110,814.81
Mallra dhe shërbime	25,000.00	25,000.00	30,000.00
Shpenzime komunale	7,000.00	7,000.00	9,700.00
Subvencione dhe transfere	-	-	-
Shpenzime kapitale	23,000.00	-	-
TOTALI:	**155,512.30**	**137,527.92**	**150,514.81**

SHERBIMET REZIDENCIALE	BUXHETI		
Kategoria Ekonomike	**2021**	**2022**	**2023**
Paga dhe mëditje	90,000.00	94,500.00	90,000.00
Mallra dhe shërbime	67,000.00	62,500.00	67,000.00
Shpenzime komunale	8,000.00	8,000.00	8,000.00
Subvencione dhe transfere	-	-	-
Shpenzime kapitale	20,000.00	20,000.00	20,000.00
TOTALI:	**185,000.00**	**185,000.00**	**185,000.00**

1. Objektivat e Performancës

Matjet Kryesore të Përformancës	*2019*	*2020*	***2020***
Vizita mjekësore	200.000	210.000	215.000
Shërbime përcjellëse shëndetësore (injeksione, infuzione, inhalime, pastrim dhe përpunim plagësh, EKG etj)	300000	355000	260000
Vizita mjekësore shtëpiake	1000	1100	1200
Vizita stomatologjike	12000	15000	20000
Vizita konsultative – specialistike (pediatri, radiologji, pulmologji, mjekësi pune)	40000	45000	50000

Vizita gjinekologjike me rreth 400 lindje (materniteti, gjinekologjia, këshillimorja etj.)	8000	9000	10000
Shërbime stomatologjike	200000	220000	25000
Shërbime laboratorike (analiza biokimike, hematologjie dhe bakteriologjike)	90000	95000	100000
Shërbime në rëntgen dhe ultrazëri	8000	8500	9000
Vaksinimi i fëmijëve në teren	20000	1900	1850
Edukimi i vazhdueshëm profesional (mjekë dhe tek.)	50	50	50
Edukimi shëndetësor i popullatës në teren(13 QF x 2)	45	50	55
Bartja e pacientëve në QKU për trajtim të mëtejshëm)	2000	1800	1700
Bartja e pacientëve për dializë(10.000 km) trajtimi tri herë në javë	19	20	22

14. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Deklarata e misionit

- *Që të zhvillojë dhe të siguroj me efektivitet dhe efikasitet:*
- *Kushtet higjieniko-sanitare dhe teknike në ambientet ku qytetarët e Skenderjt jetojnë, punojnë, edukohen, shërohen, argëtohen, etj.*
- *Normat dhe standardet e operatorëve që kryejnë veprimtari ligjore nga kompetenca e kësaj drejtorie,*
- *Implementimin e masave dhe programeve preventive përmes zhvillimit dhe forcimit të inspektimeve kompetente ligjore.*

Deklarata e Vizionit : Vizioni i DI-së është mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e shëndetit publik, mbikqyrja dhe aplikimi i ligjeve për planin zhvillimor, rregullativ dhe urbanistik, përmes inspektimeve, vendimeve, pëlqimeve, evidentimeve dhe ndërmarrjen e masave ligjore ndaj subjekteve – operatorëve që kryejnë veprimtari joligjore nga kompetenca e kësaj drejtorie duke siguruar kushte dhe ambient të shëndoshë për qytetarët e komunës.

Deklarata e Qëllimit: Mbikqyrja dhe aplikimi i ligjeve dhe akteve tjera ligjore në fushën e ndërtimit, tregut sanitar, veterinarisë, bujqësisë, mbrojtjes së ambientit, trafikut urban - komunikacionit, hidroekonomisë, rrugëve etj. Promovimi i kushteve higjieniko - sanitare dhe teknike në institucionet publike dhe private. Zhvillimi i resurseve humane dhe forcimi i llogaridhënies

Niveli i kodit ekonomik projeksionet e buxhetit 3 vjeçar

INSPEKTIMET	BUXHETI		
Kategoria Ekonomike	**2021**	**2022**	**2023**
Paga dhe mëditje	54,852.00	57,594.60	60,474.33
Mallra dhe shërbime	30,400.00	30,400.00	32,000.00
Shpenzime komunale	-	-	-
Subvencione dhe transfere	-	-	-
Shpenzime kapitale	30,000.00	-	-
TOTALI:	**115,252.00**	**87,994.60**	**92,474.33**

Skenderaj,
Datë 11.06.2019

Kryetari i Komunës
z. Bekim Jashari

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ
Nr. No. 10-320/01-0017917/20
Data 08-06-2020

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
Direkcija za Poljoprivredu Šumarstvo i Ruralni Razvoj
Department of Agriculture Forestry and Rural Development

DATË/A:	**08.06.2020**
REFERENC-Ë:	///
PËR/ZA/TO:	**Komitetin për Politikë dhe Financa**
PËRMES/PREKO/THROUGH:	**Zyrës së Kryetarit të Komunës së Skenderajt, z. Bekim JASHARI**
NGA/OD/FROM:	**Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural - Sokol SALLAHU**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**Propozim për Miratimin e Granteve të DBPZHR-së për Vitin 2020**

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në kuadër të implementimit të Memorandumit për Bashkëpunim me Islamic Relief Kosova me Nr. 02-320/01-0016744/20 të datës 02.06.2020. Si dhe në kuadër të kompetencave ekskluzive që i përkasin interesit lokal, në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, neni 62, paragrafi 62.3 dhe 62.4, të ndërlidhura me nenin 58 nën h), si dhe nenit 9 të rregullorës për ndarjen e subvencioneve të komunës së Skenderajt Nr. 01-110-33792 të dt. 16.06.2015, dhe statutit të komunës së Skenderajt me Nr. 01-110-385 të dt. 03.12.2008 të Kuvendit të Komunës, DBPZHR për mbledhjen e rregullt të dt.___.06.2020 propozon këtë:

PROPOZIM

1. Miratimin paraprak të vendimit mbi lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare në shumën prej **25,100.00 €** (njëzetepesëmijëenjeqindeuro) nga fondi i bashkëfinancimit për Memorandumin më Islamic Relief Kosova për Vitin 2020 në formë të përkrahjes direkte për fermerët e komunës së Skenderajt, duke përfshirë mbështetjen e fermerëve me këto grante:
   - 25 familje secila me nga 1 mëshqerrë barrëse;
   - 36 familje secila me nga 19 pula 1 gjel dhe kotec;
   - 5 familje secila nga 1 serrë 100m^2;
   - Barnat veterinare, dhe ilaqet për kontrolle të rregullta, ushqim për bagetitë dhe shpezët (lopë dhe pula).
2. Propozim për shfrytëzimin e mjeteve nga pika 1 (një) e këtij propozimi bëhët për implementimin e Memorandumit për Bashkëpunim (MpB) me Nr. 02-320/01-0016744/20 të datës 02.06.2020

Shtojcë: Bashkangjitur këtijë propozimi, gjeni Marrëveshjen për Bashkëpunim (MpB) në mes të komunës së Skenderajt dhe Islamic Relief Kosova.

Komuna Skenderaj

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SKENDERAJ

Nr. 02-320/01-00.16744/20
Data 02.06.2020

Islamic Relief Kosova

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI / MEMORANDUM OF COOPERATION

Ndërmjet / Between

Islamic Relief Worldwide – Zyra në Kosovë (IRW) / IRW Kosovo Office

dhe / and

Komuna e Skenderajt / Municipality of Skenderaj

Për realizimin e projektit humanitar përmes së cilës përcaktohen kushtet mes **Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW) dhe Komuna e Skenderajit** në lidhje me Memorandumin e Bashkëpunimit për projektin **"Mbështetje e qëndrueshme e jetesës për familjet me jetimë dhe në nevojë, përmes fermave të vogla bujqësore dhe me bagëti"** për Komunën e Skenderajsë. Që është pjesë e projektit të IRW me pin kod numër 020-00362 përkrahur nga zyra e Islamic Relief në Malaysia	For the realization of the humanitarian project through the service of conditions between Islamic Relief Worldwide - office in Kosovo (IRW) and the Municipality of Skenderaj regarding the join of the Memorandum of Cooperation for the project "Sustainable livelihood support for orphan and needy families through small farming with livestock " for the Municipality of Skenderaj which is part of the IRW project with pin code number 020-00362 supported by Islamic Relief office in Malaysia.
Neni 1 **Qëllimi I marrëveshjes**	**Article 1** **Purpose of the agreement**
1.1 Qëllimi i kësaj marrëveshje është të përcaktojë formën e bashkëpunimit mes IRW dhe Komunës me qëllim të implementimit dhe finalizimit të projektit që ka për qëllim përkrahjen e familjeve me ferma të vogla ne rritjen, zhvillimin dhe prodhimtarinë e tyre bujqësore e blegtorale që implementohet nga ana e IRW.	1.1 The purpose of this Agreement is to define the form of cooperation between IRW and the Municipality with the aim of implementing and finalizing a project aimed at supporting families with small farms in their growth, development and agricultural and livestock production implemented by IRW
1.2 Përfitues nga ky projekt do të jenë të gjithë banoret e Komunës së Skenderajsë që llogaritet të jenë rreth 51, 317 banorë.	1.2 Beneficiaries of this project will be all residents of Skenderaj municipality estimated to be around 51,317. Of these, the direct beneficiaries are approximately:
1.3 Prej tyre përfitues direkt përafërsisht llogaritet të jenë: - 25 familje me lopë (secila nga një),	1.3 Of these, the direct beneficiaries are approximately: - 25 families with cows (each one), - 36 families with 20 chickens per family (19

ISLAMIC RELIEF

A.G

- 36 familje me nga 20 pula për familje (në përbërje 19 pula dhe 1 gjel për familje),
- 5 familje (sera),

*Familjet do të përfitojnë edhe, kontrolle shëndetësore të kafshëve nga veterineri, trajnime, ushqim për së paku nëntë (9) muaj.

Neni 2
Përshkrimi i projektit

2.1 Menaxhues i projektit është IRW në bashkëpunim me Drejtorinë për Bujqësi – Skenderaj, dhe participimi i Komunës do të bëhet me anë të transferit të mjeteve të komunës në llogarinë bankare të IRW NLB 1708200008014285, pas nënshkrimit të marrëveshjes. IRW do të dërgoj raporte mbi shpenzimet së bashku me faturat e skanuara.

2.2 Përzgjedhjen e përfituesve, organizimin, implementimin, monitorimin si dhe raportimin për implementimin e projektit do ta bëjnë komisionet përkatëse nga Komuna e Skenderajt dhe IRW të cilët do të jenë në bashkëpunim të rregulit me kordinaroret e projektit.

Neni 3
Obligimet e palëve

3.1 **Participimi financiar**

3.1.1 Në kuadër të projektit me pin kod 020-003462 IRW do të sigurojë pjesën e fondeve në vlerë prej **47,600.00€** (katërdhjetë e shtatë mijë e gjashtë qind euro) ose **65%** të vlerës totale për implementim të këtij projekti ashtu siç është paraqitur në shtojcën A të kësaj Marrëveshje.

3.2 Në kuadër të buxhetit Komunal, Komuna do të participojë me kontribut financiar në shumën prej **25,100.00€** (njëzet e pesë mijë e njëqind) ose **35%** për implementimin e këtij projekti ashtu siç është paraqitur në shtojcën A të kësaj Marrëveshje.

3.2.2 Total vlera e projektit është **72,700.00 € (shtatëdhjetë e dymijë e shtatë qind euro)** derisa shpenzimet për shërbime do të bëhen sipas zërave që janë paraqitur në shtojcën A të kësaj marrëveshje.

Neni 4
Përgjegjësitë e palëve

4.1 Është e kuptueshme nga të dyja palët nënshkruese

- 36 families with 20 chickens and 1 rooster per family),
- 5 families (greenhouses),

* Families will also benefit from, veterinary animal health checks, training, food for at least nine (9) months.

Article 2
Project description

2.1 The project is managed by IRW in cooperation with Directorate for Agriculture – Skenderaj, and the municipality's participation will be made by transferring the municipality's funds to the bank account of IRW NLB 1708200008014285, after signing the agreement. The IRW will send expense reports along with scanned invoices.

2.2 Selection of beneficiaries, organization, implementation, monitoring and reporting on project implementation will be done by the relevant commissions from the Municipality of Skenderaj and IRW who will be in regular cooperation with the project coordinators.

Article 3
Obligations of the parties

3.1 **Financial participation**

3.1.1 Under the pin code project 020-003462 IRW will provide part of the funds in the amount of **47,600.00€** (forty-seven thousand six hundred euros) or **65%** of the total value for implementation of this project as set out in Annex A of this Agreement.

3.2 Within the Municipal Budget, the Municipality shall contribute with a financial contribution of **25,100.00€** (twenty five thousand and hundred) or **35%** for the implementation of this project as set forth in Annex A to this Agreement.

3.2.2 The total value of the project is **72,700.00 € (seventi two thousand and seven hundred euros)** while the costs for services will be incurred in accordance with the items set out in Annex A to this Agreement.

Article 4
Responsibilities of the parties

4.1 It is understood by both parties to this Agreement

A.5

të kësaj marrëveshjeje që çdo palë duhet të jetë e aftë për të përmbushur përgjegjësitë sipas kësaj marrëveshjeje. Nëse në çdo kohë komuna nuk është në gjendje të kryejë funksionet e saj sipas Marrëveshjes, menjëherë do të njoftojë IRW - Koordinatoren e Programit si dhe e kundërta.

4.2 Të dyja palët bien dakord për të emëruar koordinatorët për zbatimin e suksesshëm të kësaj marrëveshjeje.

4.3 Koordinatorët do të jenë përgjegjës për rolet e institucionit të tyre dhe për të siguruar zbatimin e suksesshëm të dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

4.4 Komuna e Skenderajt, me një anëtar të komisionit do të marrë pjesë në vlerësimin e ofertave për zgjedhjen e kontraktuesve, dhe në rast të ndonjë parregullsie, është i detyruar të raportojë pranë institucioneve përgjegjëse.

4.5 Personi kontaktues i caktuar nga Komuna pranon të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e kësaj marrëveshjeje si dhe personi kontaktues i caktuar nga IRW pranon të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe implementimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 5
Koordinatorët

5.1 Koordinatori për IRW
Emri: Blerim Gashi
Adresa: Rruga Bajram Kelmendi, NO. 10/ A
Prishtinë, Republika e Kosovës
Zyra Telefon: 038 232 431 / mob.044/239-349
Email: blerim.gashi@ir-rks.org

5.2 Koordinatori për Komunë
Emri: Dervish Xhemajli
Adresa: Skenderaj
Telefoni: +38344272793
Tel/Fax: //
Email: dervish.xhemajli@rks-gov.net

Neni 6
Gjuha zyrtare e marrëveshjes

6.1 Gjuha që mbizotëron në këtë marrëveshje është versioni në Gjuhën shqipe.

that each party must be capable of fulfilling its responsibilities under this Agreement. If at any time the municipality is unable to perform its functions under the Agreement, it shall immediately notify IRW - Program Coordinator and vice versa.

4.2 Both Parties agree to appoint coordinators for the successful implementation of this Agreement.

4.3 The Coordinators shall be responsible for the roles of their Institution and for ensuring the successful implementation of the articles of this Agreement.

4.4 The Municipality of Skenderaj, with one member of the commission will participate in the evaluation of bids for the selection of contractors, and in case of any irregularities it is obliged to report to the responsible institutions.

4.5 The Contact Person designated by the Municipality agrees to be responsible for the development and implementation of this Agreement and the Contact Person designated by IRW agrees to be responsible for the development and implementation of this Agreement.

Article5
Coordinators

5.1 IRW Coordinator
Name: Blerim Gashi
Address: Bajram Kelmendi Street, NO. 10 / A
Pristina, Republic of Kosovo
Office Phone: 038 232 431 / mob.044 / 239-349
Email: blerim.gashi@ir-rks.org

5.2 Coordinator for the Municipality
Name: Dervish Xhemajli
Address: Skenderaj
Phone: +38344272793
Tel / Fax: //
E-mail: dervish.xhemajli@rks-gov.net

Article 6
Official language of the agreement

6.1 The language prevailing in this Agreement is the Albanian language version.

A. G -3-

Neni 7 Kohëzgjatja e marrëveshjes	Article 7 Duration of the agreement
7.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit të Drejtorit për Kosovë të Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë, dhe kryetarit të Komunës së Skenderajsë, dhe do të vazhdojë deri më 31.05.2021 kur pritet edhe të përfundojë realizimi dhe faza e monitorimit të projektit.	7.1 This Agreement shall enter into force upon signature of the Director for Kosovo of the Islamic Relief Worldwide office in Kosovo, and the Mayor of Skenderaj, and shall continue until 31.05.2021 when the implementation and monitoring of the project is expected to be completed.
Neni 8 **Mosmarrëveshjet**	**Article 8** **Disputes**
8.1 Në rast të ngecjeve të realizimit të projektit palët pajtohen që të bëjnë ndryshimin e kësaj marrëveshjeje për një periudhë tjetër me aneks të ri të kësaj marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga të dyja palët.	8.1 In the event of project implementation delays, the Parties agree to amend this Agreement for another period with a new Annex to this Agreement in writing and signed by both parties.

Shtojca (A) e Memorandumit për Bashkëpunim
"Mbështetje e qëndrueshme e jetesës për familjet me jetimë dhe në nevojë, përmes fermave të vogla bujqësore dhe me bagëti"

Nr	Aktiviteti	Njësi	Muaj	Çmimi për njësi	Total IRW Malaysia	Total Komuna	IRW Malaysia	Komuna	IRW e Municipality
1	Staf vlerësimi 2 anëtarë për procesin e Përzgjedhjes së përfituesve	2	1	€ 350	€ 700	€ -	100%	0%	€ 700
2	Transporti dhe Logjistika Karburanti për nevojat e zbatimit	1	9	€ 150	€ 1,350	€ -	100%	0%	€ 1,350
3	Trajnim për Përfituesit Për lopët, materialet e pulave dhe praktikantët	2	1	€ 100	€ 200	€ -	100%	0%	€ 200
4	Tarifat e punës / Stafi i përkohshëm Koordinatori i projektit.	1	12	€ 430	€ 5,160	€ -	68%	32%	€ 5,160
5	Monitorimi dhe Vlerësimi i Jashtëm dhe i Brendshëm dhe Vlerësimi Formulari i Monitorimit dhe Vlerësimit IRW dhe / ose Malajzi	1	1	€ 300	€ 300	€ -	100%	0%	€ 300
6	Monitorimi dhe Vlerësimi i Jashtëm dhe i Brendshëm dhe Vlerësimi Formulari i Monitorimit dhe Vlerësimit Stafi i IRKS	1	1	€ 200	€ 200	€ -	100%	0%	€ 200
7	Mjetet e gjenerimit të të ardhurave 14 Lopë për 14 familje (11, lopë shtesë për 11 familje nga Komuna e Skenderajt)	14	1	€ 1,500	€ 21,000	€ 16,500	56%	44%	€ 37,500
8	Mjetet e gjenerimit të të ardhurave 21 familje me 21 shpendë për familje (që përbëhen nga 19 pula dhe 1 gjel për familje) - (15 familje shtesë do të përfitojnë nga Komuna e Skenderajt)	21	1	€ 240	€ 5,040	€ 3,600	58%	42%	€ 8,640
9	Mjetet e gjenerimit të të ardhurave 5 familje me serra (marrin nga një serë secila)	5	1	€ 1,250	€ 6,250	€ -	100%	0%	€ 6,250

A.S

10	Aktivitetet e shëndetit të kafshëve Barnat veterinare dhe ilaçet për kontrolle të rregullta te bagëtitë	1	4	€ 300	€ 1,200	€ 1,200	50%	50%	€ 2,400
11	Artikujt e mjeteve të jetesës furnizojnë ushqim për bagëtinë (lopë, pula) për periudhën e projektit - (20 njësi shtesë nga komuna Skenderaj)	20	1	€ 100	€ 2,000	€ 2,000	50%	50%	€ 4,000
12	Pulat e Përhershme të Strehëzave - një shtëpi pule secila (gjithsej 21 shtëpi) - (15 familje shtesë do të përfitojnë nga Komuna e Skenderajt)	21	1	€ 120	€ 2,520	€ 1,800	58%	42%	€ 4,320
13	Fotografitë e publicitetit dhe video për nevojat e projektit	1	1	€ 500	€ 500	€ -	100%	0%	€ 500
14	Shpalljet Tenderi i Hapur	1	1	€ 40	€ 40	€ -	100%	0%	€ 40
15	Shpenzimet e telekomunikacionit Kryerja për nevoja të projektit	1	12	€ 20	€ 240	€ -	71%	29%	€ 240
16	Shpenzimi i automjeteve Mirëmbajtja e automjeteve gjatë përdorimit të projektit	1	1	€ 500	€ 500	€ -	100%	0%	€ 500
17	Shpenzimi i automjeteve Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve	1	1	€ 250	€ 250	€ -	100%	0%	€ 250
18	Tarifat e Auditimit të Jashtëm Tarifa e Auditimit të Përjetshëm	1	1	€ 150	€ 150	€ -	100%	0%	€ 150
Kosto totale:					€ 47,600	€ 25,1[illegible]	[illegible]%		€ 72,700

Islamic Relief Worldwide – Kosova Office

Dr. Mohamed Soliman

Country Director Islamic Relief Kosova

Data/Date: 15/05/2020

Komuna e Skenderajt / Municipality of Skenderaj

Z. Bekim Jashari

Kryetar i Komunës së Skenderajt

Mayor of Skenderaj Municipality

Data/Date: 15.05.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA SKENDERAJ
Nr. No. 13-334/01-002/384/20
Data Data 22.06.2020

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Inspekcion
Direkcija za inspekciju
Directorate for Inspection

DATË/A:	22/06/2020
REFERENC-Ë:	-
PËR/ZA/TO:	Sekretarinë e Asamblesë Komunale
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Arkivit
NGA/OD/FROM	Drejtor, Arton Veliu
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT-	Informatë rreth aktiviteteve të Drejtorisë për Inspekcion për periudhën Janar- Qershor 2020.

Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria për Inspekcion, ne mënyre të vazhdueshme ka zhvilluar aktivitete inspektuese ne fushat që mbulon ky resor.

Synimi parësor i yni ka qenë dhe mbetet mbrojtja e shëndetit të e konsumatorëve dhe luftimi i informalitetit.

Ne total numri i Inspektimeve neper subjekte afariste afërsisht shkon ne shifrën e **400 (katërqind)** vizitave .

Meqenëse fillimi i këtij viti ka qenë me specifik se fillimet e viteve tjera për shkak të shfaqjes së virusit vdekjeprurës Covid- 19 (Corona Virus),virus i cili ka përfshirë pjesën me të madhe të globit, atëherë edhe ne, është dashur që komfor rrethanave të krijuara të marrim masa parandaluese ndaj këtij virusi në shërbim të mbrojtjes së jetëve të qytetarëve tanë.

Komfor situatës së krijuar detyrimisht kemi qenë të obliguar që ti shmangemi planit bazë të punës për vitin 2020.

Ne vazhdim ju paraqes aktivitetet e drejtorisë për Inspekcion ne fazën kritike të pandemisë:

Me rastin e shfaqjes së rrezikut për përhapjen e pandemisë globale Corona Virus Covid-19,Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Shëndetësisë me rekomandime nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik ka marrë masa preventive si masë frenuese e përhapjes së këtij virusi vdekjeprurës.

Ne kuadër të këtyre masave Qeveria e Kosovës ka nxjerre një sërë vendimesh dhe urdhëresash të cilat mandej janë deleguar për mbikëqyrje të zbatimit të tyre ne Drejtoritë Komunale të Inspekcionit, sidomos kufizimet që kanë të bëjnë me aktivitetin e subjekteve afariste.

Drejtoria e Inspekcionit në Skenderaj ne funksion të zbatimit të këtyre masave qeveritare dhe vendimeve të nxjerrura nga Shtabi Emergjent i Komunës , me kapacitete të plota është angazhuar dhe ka punuar në zbatimin e tyre .

Aktivitetet e Drejtorisë për Inspekcion gjatë kësaj periudhe janë si me poshtë:

Fillimisht i kemi njoftuar operatoret ekonomik me masat e marra nga Qeveria e Kosovës, i kemi njoftuar me përmbajtjen e këtyre masave ,ne bazë të regjistrit qeveritar i kemi njoftuare se cilat kanë drejtë të punojnë e cilat jo , pothuajse janë vizituar të gjitha derë me derë.

Mandej kemi vazhduar tek subjektet afariste që kanë drejtë pune, i kemi njoftuar me kushtet mbi të cilat duhet të operojnë.

Janë urdhëruar të gjithë pronaret e subjekteve afariste të cilat me vendim të qeverisë i 'u lejohet të punojnë, qe të bëjnë dezinfektimin e lokaleve , si dhe të aplikojnë masat mbrojtëse (dorëza ,maska) për stafin e punës si dhe dezinfektuesve ne hyrje për konsumator.

Kemi marrë masa për ndërprejen e transportit të udhëtareve në linjat urbano-periferike te komunës tone.

Kemi ndërprere shërbimet e auto-taxive dhe shërbimet radio taxi.

Kemi mbyllur dy tregjet, tregun e gjelbërt ne qytet dhe tregun e kafshëve ne Polac.

Të gjithë prodhuesve të bukës i 'u janë dhënë urdhëresa për aplikimin e qeseve nga letra me rastin e shitjes se produkteve të miellit , vendosja e shënjezimeve për mbajtjen e distancës sociale si dhe përdorimin i dezinfektuesit.

Kemi punuar në parandalimin e abuzimit me çmime nga subjektet afariste të papërgjegjshme.

Në dy raste për shkak të rritjes artificiale të çmimit kemi marrë masa ndëshkimore ndaj subjekteve në fjalë.

Njëri rast ka qenë në njërën prej barnatoreve në qytet, ndaj subjektit është aplikuar masa ndëshkimore (gjobë) ne vlerë prej 500 (pesëqind) euro ,dhe rasti tjetër në njërën nga qendrat tregtare ne qytet me çrast kemi hasur në mospërputhje të çmimit të produktit, ndërmjet çmimit të vendosur ne raft dhe çmimit ne skaner.

Subjekti në fjalë është gjobitur 500 (pesëqind) euro.

Pothuajse çdo ditë janë vizituar dyqanet ushqimore dhe farmacitë me qëllim që mos të lejojmë rritje të çmimeve, kemi punuar për të parandaluar vjedhjen e mundshme ne xhepat e konsumatorëve.

Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës ,për mospërfillje të vendimit të qeverisë për mbyllje të veprimtarisë ne kohën e pandemisë ,kemi mbyllur 10 (dhjetë) subjekte afariste, shumica prej tyre mini bare kafeje.

Për mbyllje kemi përdorur vulën e Inspektoratit, ndërsa për veprime të mëtutjeshme ndaj shkelësve rasti ka kaluar të prokurori i shtetit .

Pas vendimit të Shtabit Emergjent Komunal për futje ne karantinë të një pjese të lagjes "Thaqi" të fshatit Burojë pasi që në një familje të kësaj lagjeje kanë rezultuar pozitiv, kemi mbyllur tre subjekte afariste ne këtë fshat të cilat kanë qenë kontakte me personat e infektuar.

Me pas këto subjekte janë rihape pasi që janë kryer testet e stafit punonjës dhe kanë dezinfektuar hapësirën e lokaleve dhe kanë rezultuar negativ.

Ne të gjitha dyqanet ushqimore i kemi urdhëruar pronaret apo menagjerët vendosjen e shenjave për mbajtjen e distancës sociale si dhe për dezinfektimin e shportave ne përdorim.

Të gjitha qendrat tregtare janë urdhëruar që të kufizojnë me shirita pjesën e tekstilit dhe gastronomisë.

Ne dy raste për mosrespektim të këtyre urdhëresave (d.m.th. kemi konstatuar që kanë shitur produkte të tekstilit përkundër qe e kanë të ndaluar).

Ne të dy rastet kemi shqiptuar masa ndëshkimore (gjoba) ,2 x 200 (dyqind) euro, të cilat tashmë janë paguar nga operatorët ne fjalë.

Ne koordinim me Ministrinë e Shëndetësisë kemi hartuar orarin e kujdestarisë për barnatoret e qytetit, si dhe kemi mbikëqyre zbatimin e tije.

Në dy javët e fundit të cilat janë cilësuar si me kritike, ku sipas vlerësimeve nga MSH-ja shkalla e rrezikshmërisë për tu prekur nga ky virus ka qenë me e lartë , Qeveria e Kosovës me vendim ka urdhëruar inspektorët që të merren edhe me kontrollin e lëvizjes (kohën e lëvizjes) së qytetareve.

Ne kuadër të kësaj kemi vazhduar punën ne dy turne ,dhe vlerësoj që falc angazhimit tonë dhe bashkëpunimit me Policinë e Kosovës kemi arritur që kënaqshëm ta mbajmë situatën nen kontroll.

.

Fusha e tregtisë dhe sanitarisë + hapësirat publike

Gjatë kësaj periudhe bizneset joformale jemi përpjekur që ti fusim ne kuadrin ligjor .

Ne vazhdën e këtyre përpjekjeve ,pas vërejtjeve të fundit që kanë marrë nga Inspektori i Tregut, kemi **13(trembëdhjetë) biznese të reja të regjistruara**, cilat aktivitetin e tyre kanë qenë duke e zhvilluar ilegalisht .

Dy tregjet janë mbikëqyrur vazhdimisht ,nuk kemi lejuar shitës jashtë hapësirave të'' tregut të gjelbërt ''.ndërsa të tregu i kafshëve ne Polac në vazhdimësi kemi përcjellë therjen e bagëtive dhe trajtimin e mbeturinave .

Janë shqyrtuar **15(pesëmbëdhjete)** kërkesa për pranime teknike të lokaleve ,**5 (pesë)** nga to janë aprovuar ,ndërsa për mosplotësim të kushteve për punë janë refuzuar **10(dhjetë)** nga to.

6 (gjashtë) është numri i pëlqimeve sanitare të lëshuara për ordinanca mjekësore dhe farmaci, të hyrat nga këto janë ne vlerën e **600(gjashtëqind)** eurove.

Ne kuadër të zbatimit të udhëzimit administrativ për mbrojtje të mjedisit, gjatë kësaj periudhe janë shqiptuar 10(dhjetë)gjoba në total vlerë prej **1000 (njëmijë)** eurove.

Ne total vlera e gjobave për këtë periudhe kalon shifrën **6000 (gjashtëmijë) eurove.**

Arsyet e shqiptimit të këtyre gjobave kanë qenë të ndryshme ,qoftë për mallra me afat të skaduar ,mashtrim me fatura, mospërputhje e çmimeve rafte-arkë, kushtet higjienikë jo nivel, veprimtari ilegale

,hedhje të mbeturinave ne vende jo adekuate, zjarrëvenie të qëllimshme, ekspozim të produkteve ushqimore jashtë hapësirave të lokale etj.

Gjatë kësaj periudhe janë konfiskua sasi e konsiderueshme e produkteve ushqimore(artikuj bazik të konsumit), qoftë për shkak të afatit të skaduar apo kushteve jo të përshtatshme të mbajtjes, kanë qenë rrezik potencial për konsumatorin e fundit .

Janë konfiskuar **172 (njëqind e shtatëdhjetë e dy)** produkte te ushqimore ushqimore (keksa të ndryshëm produkte qumështi etj.) ne vlerën e **304 (treqind e katër)eurove,**

26 kg produkte të mishit

Pije alkoolike : **44 (dyzet e katër) Litër verë dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) litër raki rrushi.**

Të gjitha këto produkte tashme i kemi asgjësuar nëpërmjet kompanisë ''UNITETI'', ndërsa subjekteve ku janë hasur këto produkte u kemi shqiptuar gjoba komfor legjislacionit në fuqi.

Për rastet e konfiskimit të pijeve alkoolike janë dërguar fletëparaqitje në gjykatën kompetente.

Në sektorin e gastronomisë bazuar në raportet nga terreni, gjendja e përgjithshme higjeno-sanitare e furrave të bukës, restoranteve, gjellëtoreve, fast-foodeve të ndryshme është në nivelin mesatar.

Vlejnë të theksohet se gjatë kësaj periudhe nuk kemi pranuar ndonjë ankesë për ndonjë rast të helmimit në ushqim. e njëjta gjendje pasqyrohet edhe ne raportin e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik në Mitrovicë ,ku gjatë kësaj periudhe nuk raportohet që dikush të ketë kërkuar ndihmë mjekësore për shkak të helmimit ,çka e dëshmon që niveli i sigurisë së ushqimet ne komunën tonë ka qenë relativisht i kënaqshëm.

Kemi bërë përpjekje që hapësirat publike të jenë sa me lehtësisht të qasëshme për qytetarët .

Për këtë, ne mënyre permanente kemi inspektua për largimin e shitësve ambulant nga rruga ,trotuari dhe hapësirat gjelbëruese .

Kemi punuar ne kompleksin Memorial "Adem Jashari'' ne Prekaz ,nuk kemi leju shitës ambulant në hapësirat e kompleksit .

Fusha e Transportit.

Në mënyrë që qytetarëve të iu ofrohet transport i sigurte, në koordinim të plotë me Policinë e Kosovës, kemi zhvilluar aksionin e përbashkët për kontrollin e transportit publik.

Gjatë këtij aksioni kemi 9 (nëntë) raste të operatoreve ilegal (kombi taxi dhe auto taxi) që veprojnë në transport publik, ne të gjitha këto raste për veprime të mëtutjeshme janë proceduar fletëparaqitje në gjykatën për kundërvajtje .

Gjatë kësaj periudhe janë lëshur dy pëlqim pune për dy auto taxi.

Gjithashtu kemi punuar në sinjalizimin vertikal dhe horizontal ku kemi bërë vendosjen e këtyre shenjave:

- *Vija një komponentësh 9077.25 m^1*
- *Shenja të komunikacionit 900x900 1 cop*
- *Shenja të komunikacionit 600x600 - 99 copa*

- *Shtylla për shenja - 79 cop*
- *Tabela plotësues 300x600 - 8 cop*
- *Emëra të rrugës 250x600 - 5 cop*
- *Emëra të rrugës 250x800 – 3 cop*
- *Pasqyra të rrugës - 9 cop*
- *Pengesa në rrugë - 14.5 m^1*
- *Pahi elastike – 10 m^1*
- *Shtylla të pahive elastike – 10 cop*

Në anën tjetër kemi gjithsejtë 9 (**nëntë**) kompani të licencuara të transportit publik të udhëtareve ,të cilat operojnë në komunën tonë ,duke ofruar shërbime të transportit ne llojin urbane-periferik.
Këto kompani janë të shtrira në shumicën e fshatrave të komunës dhe kënaqshëm arrijnë të përmbushin nevojat e qytetarëve për transport publik .
Gjithashtu ,si operator të regjistruar ne transportin e udhëtareve kemi, 1 (një) radio taxi dhe 11 (**njëmbëdhjetë**) auto-taxi.
Janë mbi **10(dhjetë)** kërkesa nga ana e qytetarëve për vendosjen e pengesave në rrugë (policëve të shtrirë) .të cilat për shkak të rrethanave në të cilat kemi qenë jemi detyruar që ti refuzojmë.

Fusha e ndërtimeve

Gjatë kësaj periudhe raportohet për tre raste të ndërtimeve pa leje ,një shtëpi banimi ,një aneks objekt dhe një garazh.
Janë 6 (gjashtë),objekte që kanë filluar të ndërtohen, pronaret janë të pajisur me leje ndërtimi.
Në rrugën ''ilaz Kodra'', kemi urdhëruar pronaret e kiosqeve largimin e tyre dhe vendosjen brenda stacionit të autobusëve.
Tashmë të gjitha ato kiosqe janë larguar dhe hapësira publike është komplet e lirë.
Në rrugën ''Ahmet Delia'',janë urdhëruar të gjithë pronaret e garazheve montuese ,që ti largojnë ato garazhe ,ne mënyre që të lirohet hapësira publike.
Konfirmohet që janë larguar 17 (shtatëmbëdhjetë) garazhe nga vetë pronaret dhe hapësira publike tashmë është komplet e lirë.
Në rrugën ''Ali Gashi'',kompania ''Rukolli'' është urdhëruar që ta lirojë hapësirën publike ne të cilën e ka pasur të vendosur fabrikën për prodhimin e betonit.
Kjo hapësirë tashmë është liruar.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. No. 01-060/01-002076/20
Data Data 19 06 2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Skenderaj
Skuptina Opstine Skenderaj
Skenderaj Municipal Assembly

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipality of Assembly

Komiteti për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, ka mbajtur mbledhjen e rregullt me dt. 08.06.2020 në ora 10:00.

Pas shumë diskutimesh Komiteti mori vendim që t'i drejtohet kuvendit me këto rekomandime:

1. Të bëhet një plan konkret për strategjitë e grave ndërmarrëse;
Duke pasur parasysh gjendjen me virusin Covid19, kemi parë të arsyeshme të ndihmohen gratë në qytetin tonë, duke bërë plan konkret, në të cilin të përfshihet edhe caktimi i një vendi ku do të ju mundësohej grave të promovojnë produktet dhe punën e tyre çdo javë. Pasi që jemi në një periudhë që është e domosdoshme mbajtja e distancës, mund të organizohet panairi në atë mënyrë që distanca sociale të respektohet.

2.Të organizohen panaire në bashkësitë lokale për promovimin e punës së gruas;
Duke parë panairet e mëhershme të mbajtur në qytetin e Skenderajt, kemi vërejtur interes të qytetarëve, dhe mendojmë që një sukses i tillë do të ishte nëse panaire promovuese për punën e grave do të realizoheshin nëpër bashkësi lokale. Vlerësojmë lartë punën e grave andaj kjo do të ishte një ndihmë dhe lehtësim për to.

3. Të pajisen shkollat me rafta për nxënës;
Duke pasur parasysh që nxënësit e shkollave fillore kanë një peshë të rëndë të librave dhe mjeteve shkollorë, kemi parë të domosdoshme të kontribohet për të ja lehtësuar peshën nxënësve. Kërkojmë që brenda mundësive buxhetore, të vendosen rafta në klasët e shkollave fillore.Në shtator e shohim të domosdoshme të jenë klasat gati për fillimin e vitit shkollor.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA E SKENDERAJT • KOMUNA E SKENDERAJT • KUVENDI I KOMUNËS • REPUBLIC OF KOSOVO • MUNICIPALITY OF SKENDERAJ • SKUPŠTINA OPŠTINA SKENDERAJ • REPUBLIKA KOSOVA

Kryesuesja e Komitetit
Fatmire Bajraktari

Lënda: Pyetje nga këshilltarët komunal

Për: Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë e Urbanizmit

Nga: Vjollca Ramadani, asambliste i KK në Skenderaj – Lëvizja VETËVENDSOJE!

1. **Kryetarit të Komunës**

Kryetar, a do t'iu ndihmosh në zgjidhjen e problemit me ujë të pijshëm banorëve të lagjes Hoxhaj në Plluzhinë? Problemi i tyre është rritja e kapacitetit të bazenit aktual.

2. **Drejtorisë së Urbanizmit**

Likoci vazhdon ta vuaj mungesën e ujit të pijshëm, kur pritet të shtrihet rrjeti i ujësjellësit edhe në Likoc?

Pyetje;

1. A është pranuar nga Komuna projekti i kyqjeve individuale në ujësjellës për 5 fshatra dhe nëse është pranuar nga kush është pranuar, fjala është për pranim teknik?

Pajazit Isufi - AKR